

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

# PLANI I VEPRIMIT PËR SHËNDETIN MENDOR SHQIPËRI

2023  
2026





# PLANI I VEPRIMIT PËR SHËNDETIN MENDOR SHQIPËRI

2023  
2026

Me mbështetjen e **Organizatës Botërore të Shëndetësisë**



## SHKURTIMET

ADHS	Studimi Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar
AP	Avokat i Popullit
ASCK	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës së Këshillit të Evropës
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DROSHKSH	Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
HBSC	Sjelljet e Shëndetshme në Fëmijët e Moshës Shkollore
ICD	Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve
IPA	Instrumenti i Paraaderimit
ISSH	Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KDPAK	Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
KKSHM	Komiteti Kombëtar i Shëndetit Mendor
KMD	Komisioneri Kundër Diskriminimit
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MD	Ministria e Drejtësisë
SHMMP	Shëndeti Mendor dhe Mbështetja Psikosociale
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHU	Mbulimi Shëndetësor Universal
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Parësor
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHKSH	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PAK	Personat me Aftësi të Kufizuar
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm
QBZ	Qendra e Botimeve Zyrtare
QKSHM	Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor
QKTRF	Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët
QSUT	Qendra Spitalore Universitare Tiranë
QSH	Qendra Shëndetësore
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
RCMH	Qendra Rajonale për Shëndetin Mendor
SEEHN	Rrjeti Shëndetësor i Evropës Julindore
SJT	Sëmundje Jo të transmetueshme
SKV	Sëmundjet Kardio-Vaskulare
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TiT	Trajnim Trajnerësh
UM	Universiteti i Mjekësisë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

# PËRMBAJTJA

<b>Hyrje</b> .....	<b>6</b>
<b>Analiza e Situatës</b> .....	<b>7</b>
• Fakte mbi shëndetin mendor .....	7
• Kuadri zhvillimor orientues i planit të veprimit .....	10
• Shërbimet e shëndetit mendor .....	14
<b>Vlerësimi i Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri, 2013-2022</b> .....	<b>16</b>
<b>Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor, Shqipëri, 2023-2026</b> .....	<b>17</b>
• Vizioni .....	17
• Qëllimi .....	17
• Parimet .....	17
• Objektivat strategjike .....	19
• Objektivat specifike dhe masat për zbatim .....	21
<b>Monitorimi dhe Vlerësimi</b> .....	<b>39</b>
<b>Përshkrimi i buxhetit dhe matrica e Planit të Veprimit</b> .....	<b>39</b>
• Kostot e vlerësuara dhe burimet e financimit .....	39
• Matrica e planit të veprimit e buxhetuar .....	42

# HYRJE

Shëndeti mendor është gjendja e mirëqenies mendore që u mundëson njerëzve të përballojnë streset e jetës, të realizojnë aftësitë e tyre, të mësojnë dhe të punojnë, si dhe të kontribuojnë në komunitetin e tyre. Ai është një element thelbësor i shëndetit dhe mirëqenies që mbështet aftësitë tona individuale dhe kolektive për të marrë vendime, për të krijuar marrëdhënie dhe për të formësuar botën ku jetojmë. Shëndeti mendor është një e drejtë themelore e njeriut dhe është thelbësor për zhvillimin personal, komunitar dhe socio-ekonomik<sup>1</sup>.

Mbi këtë bazë, promovimi, parandalimi, trajtimi, rehabilitimi, kujdesi dhe rimëkëmbja konsiderohen treguesit kryesorë në përgjigjet ndaj problematikave të shëndetit mendor në mbarë botën<sup>2</sup>.

Në këtë këndvështrim, MSHMS i ka dhënë përparësi shëndetit mendor në agjendën e saj 2030 dhe e ka zyrtarizuar në dokumentin strategjik kombëtar në fushën e shëndetësisë, duke synuar edhe përmbushjen e prioriteteve të OZHQ-ve të OKB-së, si dhe në zbatim të SKZHI-së.

Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026 është hartuar në mbështetje të tri planeve të mëparshme në këtë fushë dhe reflekton qasjen zhvillimore në përfundim të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013-2022, të hartuar në zbatim të Politikës për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri (2003). Ky dokument i ri politik për shëndetin mendor është në përputhje të plotë me kuadrin strategjik në fushën e shëndetësisë dhe atë të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale, si dhe me të drejtat e njeriut.

Plani i Veprimit për shëndetin mendor mbështet parimin "nuk ka shëndet pa shëndet mendor", identifikon objektiva strategjike dhe masa ndërhyrjeje bazuar në sfidat pas pandemisë dhe zhvillimet e sektorit drejt mbulimit shëndetësor universal dhe synon të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe personave me aftësi të kufizuara.

Ky plan veprimi synon të sjellë një qasje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe adoleshentët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara mendore, migrantët, viktimat e dhunës dhe trafikimit, etj., si grupe në nevojë për kujdes të veçantë të shëndetit mendor.

1 OBSH. Fuqizimi i përgjigjeve tona. 2022. <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/mental-health-strengthening-our-response>

2 OBSH. Plani i Integruar i Veprimit për shëndetin mendor 2013-2030 <https://www.who.int/publications/i/item/9789240031029>

# ANALIZA E SITUATËS

## Fakte mbi shëndetin mendor

Shëndeti mendor dhe mirëqenia personale rrezikohen nga faktorë personalë, shoqërorë dhe mjedisorë, si varfëria, papunësia, përjashtimi shoqëror, dhuna, konfliktet apo situatat e emergjencave.

Problematikat e shëndetit mendor mund të shfaqen në çdo moshë. Fëmijëria dhe adoleshenca janë periudha të rëndësishme formuese dhe zhvillimore, ndaj përballja me përvoja dhe situata të pafavorshme gjatë këtyre fazave të hershme të jetës mund të ketë efekte të dëmshme në zhvillimin e aftësive njohëse dhe emocionale apo mirëqenien dhe shëndetin mendor për të ardhmen.

Kuadri Rregullator Evropian i Veprimit për Shëndetin Mendor (OBSh), në vlerësim të situatës së shëndetit mendor për rajonin, thekson se numri i personave me çrregullime të shëndetit mendor (përfshi depresionin, çrregullimet e ankthit dhe psikozën tek të rriturit, si dhe çrregullimet e zhvillimit dhe të sjelljes tek fëmijët dhe adoleshentët) në vitin 2019 raportohet në 125 milionë, ose 13% të popullsisë së rajonit evropian. Kur këto raste dhe të tjera i referohen aftësisë së kufizuar, problematikat e shëndetit mendor përbëjnë 15% të jetesës me aftësi të kufizuara. Në nivel global, numri i vetëvrasjeve në vitin 2019 raportohet në 119 000, me shtim të numrit të vetëvrasjeve tek të rinjtë<sup>3</sup>. Ndërkohë, pandemia e COVID-19 përkeqësoi ndjeshëm pasojat shëndetësore dhe socio-ekonomike të personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, duke rritur nevojën për shërbime dhe mbështetje.<sup>4</sup>

Përsa i përket *ndikimit social*, mund të thuhet se ndikimet afatgjata sociale të pandemisë mbeten për t'u parë, por tashmë është qartë fakti se këto ndikime do të jenë të mëdha dhe afatgjata, me një shtim të kërkesës për mbështetje të shëndetit mendor dhe mbështetje psikosociale<sup>5</sup>.

Edhe përpara pandemisë së COVID-19, ekspozimi ndaj përcaktuesve negativë të shëndetit mendor si dhe plakja e popullsisë në kontinentin evropian ka rezultuar në një rritje të konsiderueshme të prevalencës dhe barrës së sëmundjeve të shëndetit mendor në 30 vitet e fundit (që nga viti 1990)<sup>6</sup>.

Konteksti shqiptar paraqet problematika të ngjashme me rajonin në këtë këndvështrim. Sipas UNICEF-it, rënia e lindshmërisë<sup>7</sup> (ulje e nivelit të lindshmërisë nga 2.1 në 1.8 fëmijë për çdo grua) dhe moshimi i popullatës (me rritje prej 15% të popullatës mbi 65 vjeç) janë faktorë të rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës e për pasojë, në nevojat për kujdes shëndetësor, përfshirë kujdesin për shëndetin mendor. Të dhënat kërkimore tregojnë se 1 në 3 persona (pa përjashtime moshore) shfaqin shenja të depresionit. Dhuna fizike dhe psikologjike raportohet si mbizotëruese në 50% të rasteve të abuzimeve në fëmijëri<sup>8</sup>.

3 OBSH. Vlerësimet globale të shëndetit: jetëgjatësia dhe shkaqet kryesore të vdekjes dhe paaftësisë. Në: Observatori Global i Shëndetit 2019. <https://www.who.int/data/gho/data/themes/mortality-and-global-health-estimates>. 2022

4 OBSH. Kuadri Rregullator Evropian i Veprimit për Shëndetin Mendor 2021-2025

5 Burim: <https://www.who.int/news-room/feature-stories/detail/the-impact-of-covid-19-on-mental-health-cannot-be-made-light-of>


6 Burim: <https://www.who.int/health-topics/social-determinants-of-health>

7 UNICEF, Analiza e situatës së fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri. 2021. <https://www.unicef.org/albania/media/4071/file/Situation%20Analysis%20of%20Children%20and%20Adolescents%20in%20Albania.pdf>


8 Idem.

Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2017-2018<sup>9</sup> thekson se gratë janë më të ekspozuara ndaj depresionit se burrat. 13% e vajzave dhe grave dhe 18% e djemve dhe burrave të grup-moshave 15-59 vjeç raportojnë se ndihen në depresion për një kohë të gjatë. Në Shqipëri, ndonëse shkalla e vdekshmërisë nga vetëvrasjet të raportuara në vitin 2018 mbetet ndjeshëm nën mesataren Evropiane, me 2, 8 për 100, 000 gra dhe 6, 2 për 100, 000 burra, duhet t'i kushtohet vëmendje parandalimit të tyre dhe përgjigjes ndaj sfidave sipas rastit.

Në kontekstin e pandemisë së Covid-19, gjatë vitit 2020, në Shqipëri shtrimet për përdorimin e alkoolit dhe drogave ranë në mënyre drastike (grafiku 3), ndërkohë që për problemet e shëndetit mendor, si skizofrenia, shtrimet mbetën shumë të qëndrueshme (grafiku 4), pavaresisht pandemisë. Kjo tregon që qasja ka vijuar të mbetet pak a shumë konstante për problemet serioze të shëndetit mendor ndërkohë që rënia e shtrimeve për kategorinë e alkoolit, drogave dhe ankthit ka ardhur si pasojë e efekteve të masave kufizuese të pandemisë COVID-19.<sup>10</sup>



**Grafiku 3:** Çrregullimet e ankthit dhe varësisë nga alkooli apo drogat, shtrimet në spital sipas gjinisë për 100.000 banorë



**Grafiku 4:** Skizofrenia, shtrimet në spital sipas gjinisë për 100.000 banorë

Përmes një studimi të Departamentit të Shëndetit Publik në Universitetin e Mjekësisë (2020) me pjesëmarrjen e 2200 profesionistëve të shëndetësisë u raportuan problematika të ankthit, stresit dhe depresionit për shkak të pandemisë.

Përsa i përket grup-moshës së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve, është e vështirë të maten dhe veçanërisht të trajtohen shqetësimet e shëndetit mendor te kjo grup-moshë pa kuptuar kontekstet që krijojnë shqetësim. Ndërthurja e gjenetikës, përvojave dhe faktorëve mjedisorë që nga ditët më të hershme të fëmijërisë, duke përfshirë prindërimin, shkollimin, cilësinë e marrëdhënieve, ekspozimin ndaj dhunës ose abuzimit, diskriminimit, varfërinë, krizat humanitare dhe emergjencat shëndetësore mund të formojnë dhe ndikojnë në shëndetin mendor të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve gjatë gjithë jetës së tyre. Nga ana tjetër, dashuria dhe mirëkuptimi i prindërve, atmosfera mbështetëse e shkollës dhe marrëdhënia pozitive me bashkëmohatarët mund të ndihmojnë në uljen e rrezikut të çrregullimeve mendore, siç tregohen përmbledhtazi në tabelën e mëposhtme.

Konteksti	Rreziqet	Mbrojtja
<b>Familja</b>	Neglizhimi dhe abuzimi. Të rinjtë kanë nevojë për më shumë mbështetje nga sa ofrojnë prindërit	Prindërit dhe kujdestarët e dashur ofrojnë mirëkuptim dhe mbështetje
<b>Shkolla</b>	Presion i lartë akademik, mësues jombështetës dhe abuzues.	Mjedise shkollore të sigurta dhe mbështetëse
<b>Bashkëmohatarët</b>	Bashkëmohatarët abuzues dhe bulizues	Marrëdhënie pozitive me bashkëmohatarët, miqësi, besim

Tabela 1: Mbështetja/mbrojtja dhe rreziqet prej konteksteve të ndryshme

Ndërkohë, sipas studimeve të Sjelljeve të Shëndetshme në Fëmijët e Moshës Shkollore (HBSC) të kryera në vitet 2014 dhe 2018 në Shqipëri, ka prova se tregues të tillë si humori i ulët ose vështirësia me gjumin në vitin 2018 ishin përmirësuar krahasimshisht me vitin 2014, ose kishin mbetur në nivele të njëjta, ndërkohë që ndienjat e irritimit dhe nervozizmit shfaqnin tendencë në rritje. Djemtë vazhdimisht kishin më shumë gjasa të raportonin mirëqenie më të mirë mendore dhe këto dallime gjinore rriteshin me moshën. Prevalenca e nervozizmit, humorit të ulët, rritet me moshën tek vajzat, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

Të ndjerit me humor të ulët më shumë se një herë në javë						
	11 vjeç		13 vjeç		15 vjeç	
	2014	2018	2014	2018	2014	2018
Vajza	12%	9%	24%	20%	38%	30%
Djem	12%	8%	14%	17%	18%	16%
Të ndjerit i irrituar më shumë se një herë në javë						
	11 years old		13 years old		15 years old	
	2014	2018	2014	2018	2014	2018
Vajza	13%	19%	21%	34%	37%	40%
Djem	10%	14%	12%	21%	18%	20%
Të ndjerit nervoz më shumë se një herë në javë						
	11 vjeç		13 vjeç		15 vjeç	
	2014	2018	2013/14	2017/18	2013/14	2018
Vajza	15%	24%	26%	31%	39%	41%
Djem	12%	17%	16%	18%	22%	24%

Vështirësi me gjumin më shumë se një herë në javë						
	11 vjeç		13 vjeç		15 vjeç	
	2014	2018	2014	2014	2018	2014
Vajza	9%	10%	8%	14%	20%	20%
Djem	8%	9%	9%	16%	11%	11%

Tabela 2: Disa tregues nga studimet e Sjelljeve të Shëndetshme në Fëmijët e Moshës Shkollore (HBSC) të kryera në vitet 2014 dhe 2018 në Shqipëri

## Kuadri zhvillimor orientues i planit të veprimit

Agjenda 2030 e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)<sup>11</sup> e konsideron shëndetin jetësor për të ardhmen e botës dhe kërkon angazhim nga të gjitha vendet dhe sektorët e kujdesit shëndetësor dhe jo vetëm, për të siguruar jetë të shëndetshme dhe për të promovuar mirëqenien për të gjithë, në të gjitha moshat, duke mos lënë askënd pas. Pavarësisht se Agjenda i kushton një OZHQ shëndetit: OZHQ 3 "Sigurimi i jetës të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat", ajo gjithashtu ndërlikohet dhe kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e OZHQ-ve të tjera, në mënyra dhe forma të ndryshme, veçanërisht në shëndet mendor dhe të drejtat e njeriut, për shkak të lidhjeve të ngushta midis shëndetit mendor dhe qëllimeve të tjera, duke përfshirë barazinë, gjithëpërfshirjen dhe drejtësinë.

Kjo nismë globale për zhvillimin e qëndrueshëm, është përshtatur nga OBSH për Evropën në Programin Evropian të Punës 2020-2025.

Përsa i përket kontekstit strategjik të OBSH-së në fushën e shëndetit mendor, Plani Gjithëpërfshirës i Veprimit për Shëndetin Mendor 2013-2030<sup>12</sup>, me zgjatjen e afateve nga viti 2020 deri në vitin 2030 dhe përditësimin e vitit 2021, përcakton veprime të qarta për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien mendore për të gjithë, për të parandaluar çrregullimet e shëndetit mendor për personat në rrezik dhe për të arritur mbulim universal të shërbimeve të shëndetit mendor. Plani i përditësuar i veprimit përfshin tregues të rinj dhe të përditësuar dhe mundësi zbatimi, ndërkohë që katër objektivat kryesore mbeten të pandryshuara: udhëheqje dhe qeverisje më efektive për shëndetin mendor; ofrim i shërbimeve gjithëpërfshirëse, të integruara të shëndetit mendor dhe të kujdesit shoqëror në mjedise të bazuara në komunitet; zbatim i strategjive për promovim dhe parandalim; dhe forcim të sistemeve të informacionit, të të dhënave dhe kërkimit shkencor.

Ndërkohë, Korniza Evropiane e Veprimit për Shëndetin Mendor e OBSH-së 2021-2025<sup>13</sup> ofron një bazë koherente për veprimet e fuqizuara për të integruar, promovuar dhe mbrojtur mirëqenien mendore, si një element integral i përgjigjes dhe rimëkëmbjes ndaj COVID-19; për të luftuar stigmën dhe diskriminimin që lidhet me problemet e shëndetit mendor; për të mbështetur dhe nxitur investime në shërbime shëndetësore të arritshme të shëndetit mendor. Zbatimi dhe monitorimi i kësaj Kornize Veprimi fuqizohet nga ngritja dhe funksionimi i Koalicionit Pan-Evropian të Shëndetit Mendor, një nismë kryesore e Programit Evropian të Punës të OBSH-së 2020-2025, në të cilin bën pjesë edhe Shqipëria<sup>14</sup>.

11 <https://sdgs.un.org/2030agenda>

12 <https://www.who.int/publications/i/item/9789240031029>

13 <https://www.who.int/europe/publications/i/item/9789289057813> OBSH, 2021. <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/344609/WHO-EURO-2021-3147-42905-59865-eng.pdf?sequence=1&isAlloëed=y#:~:text=The%20WHO%20European%20Frameork%20for,mental%20health%20and%20ëell%20being>

14 Burimi: <https://www.who.int/europe/initiatives/the-pan-european-mental-health-coalition>

Konventa për të Drejtat e Njeriut, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, si dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues së Këshillit të Evropës<sup>15</sup>, për parandalimn e keqtrajtimeve të personave të privuar nga liria mbeten thelbësorë në punën për përgatitjen e Planit të Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2020<sup>16</sup> (SKZHI), është strategjia kryesore ndërsektoriale e shtetit shqiptar, në të cilën ndërthuret agenda e integrimit në BE me zhvillimin e qëndrueshëm të vendit (OZHQ) dhe projektohet vizioni i demokracisë dhe zhvillimit socio-ekonomik të vendit nëpërmjet rritjes së qëndrueshme ekonomike, rritjes së standardeve të mirëqenies dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Në këtë dokument theksohet qasja e zhvillimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor. Dokumenti i ri strategjik 2030 parashikon se kujdesi për shëndetin mendor do të jetë gjithashtu i rëndësishëm, pasi u mundëson njerëzve të realizojnë potencialet e tyre mendore dhe emocionale dhe të përballen me sukses me sfidat, duke dhënë kështu kontributin e tyre në komunitetet në të cilat jetojnë.

Në kuadër të procesit të integrimit evropian, çështjet e shëndetit mendor, më së shumti, trajtohen në kapitullin 28 "Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit publik", nënkapitulli "Shëndeti Publik". Paketa e Acquis Komunitare të BE-së për shëndetin mendor është pjesë e "Soft Acquis". Në këtë paketë përfshihen kryesisht: Konkluzionet e Këshillit mbi "Paktin Evropian për Shëndetin Mendor dhe Mirëqenien: rezultatet dhe veprimet e ardhshme"; Konkluzionet e Këshillit të atës 15 nëntor 2001 mbi luftën kundër stresit dhe problemeve të lidhura me depresionin; Konkluzionet e Këshillit të datës 2 qershor 2003 mbi luftën kundër stigmës dhe diskriminimit ndaj sëmundjeve mendore; Konkluzionet e Këshillit të datës 3 qershor 2005 mbi një Veprim të Shëndetit Mendor Komunitar. Gjithashtu pjesë e Acquis për shëndetin mendor është edhe Paketa e Veprimeve të Përbashkëta dhe dokumentet e hartuara në zbatim të saj që mbulojnë çështje të shëndetit mendor si: shëndeti mendor në të gjitha politikat, shëndeti mendor dhe shkollat, drejt shërbimeve me bazë komunitare të shëndetit mendor dhe gjithëpërfshirjes sociale, shëndeti mendor në vendin e punës dhe parandalimi i depresionit dhe vetëvrasjes, si dhe e-shëndeti, etj., të cilat projektojnë rrugën e zhvillimit të shëndetit mendor në kuadër të integrimit evropian.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 dhe Plani i saj i Veprimit, miratuar me VKM Nr. 210, datë 6.4.2022<sup>17</sup>, mbetet dokumenti kryesor strategjik në fushën e shëndetësisë, i cili përcakton se trajtimi i çrregullimeve të shëndetit mendor kërkon politika, programe ndërgjegjësimi të qëndrueshme, të përshtatura në aspektin kulturor, ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësim të qasjes në shërbimet e shëndetit mendor nëpërmjet integrimit me kujdesin shëndetësor parësor dhe shfrytëzimit të rrugëve ekzistuese të kujdesit. Strategjitë e ardhshme që synojnë trajtimin e shëndetit mendor duhet të marrin në konsideratë barrën e rëndë fizike që shoqëron problemet e shëndetit mendor, t'u japin përparësi ndërhyrjeve në vendin e punës dhe, më e rëndësishmja, të adresojnë përkeqësimin e shëndetit mendor të popullatës nga pandemia COVID-19. Më së shumti çështjet e shëndetit mendor trajtohen në Qëllimin e Politikës 1 të këtij dokumenti "Investimi në shëndetin e popullatës gjatë gjithë ciklit të jetës", përkatësisht në Objektivin Specifik 6 "Përmirësimi i programeve mbështetëse socio-shëndetësore (integruese) të shëndetit mendor, si dhe burimeve dhe kapaciteteve për zbulimin e hershëm dhe ndërhyrjet për çrregullimet e shëndetit mendor". Aspekte të ndryshme të shëndetit mendor trajtohen edhe në qëllimet e tjera të politikave, si "Progresi drejt mbulimit

15 Burim: KPT, 2020. Raporti i fundit mbi Shqipërinë, i cili orientoi ndryshimet ligjore të ligjit për shëndetin mendor; <https://www.coe.int/en/ëeb/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-the-response-of-the-albanian-authorities-to-the-report-on-the-2021-visit>

16 [https://www.kryeministria.al/ëp-content/uploads/2017/09/SKZHI\\_FINAL\\_OBZ.pdf](https://www.kryeministria.al/ëp-content/uploads/2017/09/SKZHI_FINAL_OBZ.pdf)

17 <https://www.qbz.gov.al/ëli/vendim/2022/04/06/210/8590c194-dc8b-4fa3-aa49-4140d87e11bb:q=strategjia%20kombetare%20e%20shendetesise>



shëndetësor universal”, “Fuqizimi i sistemit të integruar shëndetësor”, “Fuqizimi i reagimit të sistemit ndaj emergjencave”, si dhe “Shëndeti digjital”.

Shëndetit mendor i është dhënë një fokus i veçantë edhe në nivelin e KSHP-së, nëpërmjet parashikimeve të veçanta në dokumentin e parë strategjik të kujdesit parësor “Strategjia për Zhvillimin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020-2025”<sup>18</sup>, miratuar me VKM Nr. 405, datë 20.5.2020. Në këtë dokument synohet ofrim i kujdesit shëndetësor të integruar, cilësor, të arritshme e të përballueshme për të gjithë komunitetin dhe në kohën e duhur, nëpërmjet krijimit të modeleve të reja të shërbimeve për të mbuluar nevojat që janë identifikuar në nivel komuniteti, të tilla si: parandalimi dhe kontrolli të sëmundjeve jo të trasmetueshme (SJT), shërbimi në banesë për të moshuarit, modeleve të kujdesit përmes teknologjisë digjitale, veçanërisht në zonat e thella, ofrimin të shërbimeve të shëndetit publik, etj., si dhe duke synuar qasje më të mirë të komuniteteve të prekshme në shërbimet e kujdesit shëndetësor në plotësim të objektivit afatgjatë, atë të MSHU-së. Fuqizimi i QSH-ve me shërbime të integruara socio – shëndetësore (shtimi i stafeve psikosociale në ekipet e KSHP-së), duke u përqendruar kryesisht problemet e shëndetit mendor, por edhe shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë dhe kujdesin paliativ, është një nga ndërhyrjet më ambicioze të MSHMS-së në kuadër të zhvillimit të KSHP-së, që tashmë ka filluar zbatimin e saj.

Kuadri strategjik për SJT-të (*Programi i Parandalimit dhe Kontrollit të Sëmundjeve Jo të Transmetueshme (SJT) 2021-2030 në Shqipëri*)<sup>19</sup>, identifikon se shëndeti mendor është i rëndësishëm për parandalimin dhe menaxhimin efektiv të SJT-ve, sepse ndërvepron me shëndetin fizik në shumë mënyra dhe është një sëmundje bashkëshoqëruese e zakonshme. Vdekshmëria nga SJT-të është dy deri në tre herë më e lartë tek personat me probleme të shëndetit mendor. Stresi kronik, vetmia ose izolimi social rrit rrezikun e sëmundjeve koronare të zemrës të diagnostikuara për herë të parë. Stresi emocional afatshkurtër mund të shkaktojë episode kardiake tek individët me arteriosklerozë të avancuar dhe stresi afatgjatë mund të rrisë rrezikun e episodeve të përsëritura të sëmundjeve koronare të zemrës dhe vdekshmërisë midis atyre me sëmundje ekzistuese. Gjithashtu stresi psikologjik kontribuon në përkeqësimin e astmës dhe në personat me diabet të tipit 2 shpesh rrit nivelet e glukozës në gjak. Menaxhimi i faktorëve të rrezikut psikosocial është rekomanduar si pjesë e një qasjeje multimodale dhe me në qendër pacientin për parandalimin e SKV-ve në praktikën klinike. Duke pasur parasysh që gjysma e çrregullimeve të shëndetit mendor fillojnë para moshës 14 vjeç, parandalimi i tyre duhet të përfshijë fëmijët.

Ndërkohë, *Plani i Veprimit i Promocionit Shëndetësor 2022-2030*<sup>20</sup> thekson rolin vendimtar që luan promocioni shëndetësor në nxitjen e politikave publike të shëndetshme dhe zhvillimin e mjediseve shëndetësore mbështetëse, përmirësimin e kushteve sociale dhe aftësive personale, ndër to dhe ato psikosociale dhe të shëndetit mendor.

Në zbatim të kuadrit strategjik të përfshirjes sociale dhe në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, me në qendër Personat me Aftësi të Kufizuara, ministritë e linjës dhe institucionet kanë përcaktuar objektiva të qartë në dokumentin e ri strategjik për PAK, “*Planin Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025*”<sup>21</sup>, duke vendosur shëndetin mendor dhe çrregullimet e sjelljes ndër masat dhe treguesit kryesorë për monitorim me synim zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi. Plani synon përfshirjen dhe integrimin në shoqëri, parandalimin e diskriminimit dhe eliminimin e barrierave për të siguruar qasje në shërbimet dhe të drejtat e tyre.

18 Burimi: QBZ. 2022 <https://qbz.gov.al/previe/f61689e7-a6b0-4e0a-95a1-ec652c465d3f/fz>

19 [Programi-Kombetar-i-SJT-2021-2025\\_compressed.pdf](https://shendetesia.gov.al/Programi-Kombetar-i-SJT-2021-2025_compressed.pdf) (shendetesia.gov.al)

20 [https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/10/Plani-i-Kombetar-i-Promocionit-Shendetesor\\_compressed.pdf](https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/10/Plani-i-Kombetar-i-Promocionit-Shendetesor_compressed.pdf)

21 <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Plani20Komb%20%20Kufizuara2021-2025-4.pdf>

Në zbatim të synimeve kryesore strategjike të Dokumentit të Politikave të Reformës së Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes sociale dhe Planin e tij të Veprimit 2019-2024<sup>22</sup>, gjatë viteve të fundit janë zbatuar ndërhyrje të rëndësishme për mbrojtjen dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, ndër ta edhe personat me aftësi të kufizuara mendore, nëpërmjet zbatimit të Reformës së Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, në themel të së cilës qëndron rishikimi i sistemit aktual të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke kaluar nga modeli mjekësor i vlerësimit drejt atij bio-psikosocial.

Kriteret e reja të vlerësimit, bazohen në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit, të OBSH-së (veçmas KNF-së për fëmijët dhe për të rriturit) dhe në Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve/ICD 10, si dhe marrin në konsideratë parimet e shprehura në KDKPAK.

Përsa i përket grup-moshës së fëmijëve dhe adoleshentëve, çështjet shëndetësore të tyre, përfshirë edhe çështjet e shëndetit mendor, trajtohen edhe në dokumentin “*Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026*”<sup>23</sup>. Agjenda paraqet një hap të rëndësishëm në realizimin e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve duke adresuar njëkohësisht sfidat më domethënëse në fushën e realizimit të çështjeve që lidhen me dhe për fëmijët, përfshirë ato të krijuara për shkak të pandemisë së Covid-19. Ky dokument promovon të drejtën e fëmijëve për të jetuar në një planet të pastër dhe të shëndetshëm, në një mjedis mbrojtës, për t’u çlodhur, për të luajtur dhe për të shijuar aktivitete kulturore dhe artistike dhe për të shijuar dhe respektuar mjedisin natyror, nëpërmjet ndërhyrjeve në interesin më të lartë të tyre.

Në sektorin e arsimit, dokumenti bazë për zhvillimin e arsimit me një mandat 5-vjeçar është *Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026*<sup>24</sup> dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj<sup>25</sup>. Vizioni i MAS-it për sektorin e arsimit synon krijimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre.

*Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025*<sup>26</sup>, parashikon ndërhyrje që synojnë mbrojtjen e shëndetit mendor të personave me status penal si dhe trajtim multidisiplinar dhe rehabilitim të personave me çrregullime të shëndetit mendor brenda këtij statusi, në zbatim të Objektivit të Politikës 3 të këtij dokumenti “Ndërtimi i sistemit të drejtësisë penale mbi parandalimin, rehabilitimin, riintegrimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut”.

Masa të mëtejshme për përmirësimin e trajtimit dhe kujdesit ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore si dhe forcimin e ofrimin të kujdesit shëndetësor për të burgosurit, përfshirë kujdesin për shëndetin mendor, planifikohen të trajtohen edhe në planin e ri të veprimit për zhvillimin e sistemit të burgjeve, i cili është duke u hartuar, pas përfundimit të *Planit të Veprimit për Zhvillimin e Sistemit të Burgjeve 2019-2022*<sup>27</sup>.

22 Burimi: QBZ. 2022. <https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2019/06/05/380/e516592c-df01-4ceb-b320-bd77fae709ad;q=Dokumentit%20të%20Politikave%20të%20Reformës%20së%20Vlerësimit%20të%20Aftësisë%20së%20Kufizuar%20në%20Sistemin%20e%20Mbrojtjes%20sociale%20>

23 Burimi: UNICEF, 2022. <https://www.unicef.org/albania/sq/documents/agjenda-kombetare-te-drejtat-e-femijeve-2021-2026>

24 [https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2021/11/Vendim-621\\_date-22.10.2021\\_Per-miratimin-e-SKA-2021-2026.pdf](https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2021/11/Vendim-621_date-22.10.2021_Per-miratimin-e-SKA-2021-2026.pdf)

25 Burimi: VKM nr.621. Ministria e Arsimit. <https://arsimiparauniversitar.gov.al/vendim-nr-621-date-22-10-2021-per-miratimin-e-strategjise-kombetare-per-arsimin-2021-2026-dhe-te-planit-te-veprimit-per-zbatimin-e-saj/>

26 Burimi: VKM nr. 823. Ministria e Drejtësisë. <https://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2022/01/VKM-Nr.-823-dt.-24.12.2021-%E2%80%9CStrategjia-Nd%C3%ABrsektoriale-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-si-dhe-Plani-i-Saj-i-Veprimit-2021-2025.pdf>

27 Burimi: Plani Strategjik i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. 2019-2021. <https://rm.coe.int/actionplan-prison-system/native/1680968ab1>

## Shërbimet për shëndetin mendor

Ekziston një gamë e gjerë shërbimesh të shëndetit mendor që mund të ofrojnë forma të ndryshme mbështetjeje (përtej shërbimeve të specializuara) për personat me çrregullime të shëndetit mendor (format fizik ose online), të cilat janë përfshirë në Tabela 3:

Tabela 3: Shërbimet e shëndetit mendor

Konteksti institucional, niveli i sistemit,	Shërbimet
Institucionet e arsimit parauniversitar	Këshillim nga bashkëmoshatarët (këshilltarët e shkollave) Psikologjik; Social; Mbështetje arsimore për fëmijët me AK
Kujdesi Shëndetësor Parësor	Mjekësor Psikologjik; Social; Farmaceutik
Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor	Psikiatrik; Psikologjik; Social; Reabilitues (fizioterapi, logopedi, okupacionale, etj.).
Shërbimi spitalor	Mjekësor
Shtëpitë e Mbështetura	Mjekësor; Psikologjik; Social; Reabilitues (fizioterapi, okupacionale, etj.);
Shërbimet e shëndetit mendor të specializuara me shtretër	Mjekësor; Psikologjik; Social; Farmaceutik
QKTRF,	Mjekësor; Psikologjik; Social; Reabilitues
Qendrat e zhvillimit për PAK	Mjekësor; Psikologjik; Social; Reabilitues
Qendrat rezidenciale të përkujdesit për moshën e tretë	Mjekësor; Psikologjik; Social; Reabilitues
Komuniteti	Mbështetja informale; Shoqatat jo-qeveritare

Prezantimi i tipologjive të reja të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor me bazë komunitare, përkatësisht i QKSHM-ve dhe Shtëpive të Mbështetura, rezultoi në reduktimin e numrit të shtretërve të spitaleve/shërbimeve psikiatrike me shtretër, me fokus të veçantë reduktimin e numrit të rezidentëve kronikë të akomoduar në këto shërbime (persona me çrregullime të shëndetit mendor ose aftësi të kufizuar mendore të akomoduar prej më shumë se 5 vitesh pranë këtyre shërbimeve). Kjo ndërhyrje mundësoi që dy shërbimet e shëndetit mendor me shtretër, përkatësisht në Tiranë dhe Shkodër, tashmë të funksionojnë si shërbime akute/subakute, sipas mandatit të këtyre shërbimeve dhe në kuadër të strategjive dhe udhëzuesve ndërkombëtare që janë në favor të deinstitutionalizimit dhe kalimit drejt shërbimeve të shëndetit mendor pranë komunitetit. Në këtë kuadër, procesi i reduktimit të numrit të shtretërve psikiatrikë i zbatuar paralelisht me shtimin e shërbimeve komunitare, e ka çuar në 600 numrin e shtretërve në shërbimet e shëndetit mendor për vitin 2023 nga 900 shtretër në vitin 2000.

Për sa i përket shërbimeve komunitare, në nivel kombëtar janë ngritur dhe funksionojnë 14 Shtëpi Mbështetëse, në të cilat ofrohet trajtim rehabilitues në nivel individual për persona me çrregullime kronike të shëndetit mendor, kryesisht ish-rezidentë kronikë të spitaleve psikiatrike. Grup-mosha e "banorëve" të këtij shërbimi shkon nga 27 në 79 vjec, çka paraqet një sfidë të madhe për hartimin dhe zbatimin e planeve individuale të rehabilitimit dhe mbështetjes, e cila dikton nevojën për kategorizimin e këtyre shërbimeve, brenda tipologjisë së "shtëpive mbështetëse". Ky riorganizim duhet të adresojë edhe nevojën në rritje nga komuniteti për shërbime rehabilituese afatshkurta me qëllim shmangien e hospitalizimeve të shpeshta dhe të gjata të personave me çrregullime kronike dhe serioze të shëndetit mendor.

Bërthama e sistemit të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor është Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor. Aktualisht janë ngritur 10 QKSHM, 4 prej të cilave kanë ekipe multidisiplinare dedikuar fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilat kanë lehtësuar dhe mbështetur jetesën në komunitet të personave me çrregullime të shëndetit mendor, me fokus kryesor çrregullimet e rënda.

Prej vitesh tashmë, shërbimi i shëndetit mendor përfshin qasje trajtimi multidisiplinare me mjekë psikiatër, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, etj., numri i të cilëve po rritet nga viti në vit në dendësi me zbatimin e politikës së hapjes së specializimeve dhe të zbatimit të politikave të tjera stimuluese.

Për më shumë, në kuadër të reformimit të KSHP-së, në zbatim të qasjes socio-shëndetësore të ofrimit të shërbimeve në këtë nivel ofrimi shërbimesh, vlen të theksohet se tashmë 50 profesionistë psikosocialë janë atashuar pranë QSH-ve, me qëllim trajtimin më të mirë të nevojave të grupeve të prekshme, veçanërisht personave me probleme të shëndetit mendor, duke synuar integrimin më të mirë të shërbimeve të shëndetit mendor në KSHP. Figura të tjera, si fizioterapistë dhe logopedistë po hyjnë së fundmi në KSHP, duke pasuruar qasjen multidisiplinare të ekipit të mjekësisë së familjes në këtë nivel shërbimi.



# VLERËSIMI I PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR NË SHQIPËRI 2013-2022

Procesi i vlerësimit të planit kombëtar të veprimit për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor për periudhën 2013-2022 u ndërmor gjatë vitit 2022, me qëllim zbatueshmërisë e masave dhe ndërhyrjeve të planifikuara, identifikimin e rekomandimeve për një qasje me në qendër individin dhe shërbimeve të integruara që mbështeten tek kohezioni social dhe të drejtat e njeriut.

Metodologjia e këtij vlerësimi konsistoi në një vlerësim të hollësishëm të të gjitha ndërhyrjeve dhe aktiviteteve të kryera në kuadrin e zbatimit të këtij plani veprimi, në raport me aktivitetet e parashikuara për çdo nivel ndërhyrjesh (niveli politikave, niveli i shërbimeve, niveli i burimeve njerëzore dhe niveli i promovimit), rezultatet e pritshme dhe afatet kohore për zbatimin e tyre, si dhe në mbledhjen e të dhënave për shërbimet nga burime të ndryshme të institucioneve në nivel qendror dhe/ose vendor (MSHMS, OSHKSH, FSDKSH, ISHP, ASCK, etj.). Gjithashtu, u vlerësuan edhe nevojat për shërbime të shëndetit mendor, veçanërisht me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë, si një komponent i munguar në planin e mëparshëm të veprimit, duke u marrë në konsideratë edhe rekomandimet e OBSH-së, UNICEF-it dhe RCC/Youth Lab on Mental Health, etj.

Gjetjet e këtij vlerësimi janë baza mbi të cilën u punua për hartimin e planit të ri të veprimit për shëndetin mendor, duke marrë në konsideratë të veçantë edhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvilluar vitet e fundit në këtë fushë, me tregues të matshëm dhe të mirëpërcaktuar.

Ky proces i thelluar reflektimi orientoi përgatitjen e planit të ri të veprimit 2023-2026 bazuar në rekomandime të organizuara sipas niveleve të mëposhtme të ndërhyrjeve.

**Niveli politik:** Riorganizimi i mekanizmave qeverisës në nivel qendror dhe vendor, duke përfshirë kontributin e përdoruesve të shërbimeve të shëndetit mendor dhe të familjarëve të tyre, si dhe fuqizimin e kuadrit rregullator në fushën e shëndetit mendor;

**Niveli i shërbimeve:** Fuqizimi i shërbimeve komunitare në vlerësim të nevojave sipas grup-moshave, gjinisë dhe situatës post-COVID-19, nëpërmjet përshtetimit të proceseve për deinstitutionalizimin dhe decentralizimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe standardizimin dhe fuqizimin e shërbimeve socio-shëndetësore për përgatitjen dhe mbështetjen për jetesë të pavaruar të personave me çrregullime të shëndetit mendor, përfshirjen e digjitalizimit dhe teknologjisë së informacionit në shëndet mendor.

**Niveli i burimeve njerëzore:** Rritja e numrit të personelit dedikuar shërbimeve socio-shëndetësore dhe fuqizimi i vazhdueshëm i tij, si dhe standardizimi i praktikës së profileve profesionale.

**Niveli i promovimit:** Zhvillimi i ndërhyrjeve të promovimit dhe mbrojtjes së shëndetit mendor, me fokus grup-moshat e fëmijëve dhe adoleshentëve, të rinjtë dhe moshën e tretë, si dhe në vendin e punës, paralelisht me zbatimin e programeve parandaluese. Njohja e prevalencës së problemeve të shëndetit mendor në popullatën e përgjithshme dhe grup-mosha të veçanta dhe efikasitetit të këtyre programeve parandaluese në uljen e kësaj prevalence.

# PLANI I VEPRIMIT PËR SHËNDETIN MENDOR 2023-2026

Shëndeti Mendor përfaqëson një pjesë integrale të aftësisë së një individi për të menduar, për të përjetuar emocione, për të bashkëvepruar me të tjerët, për të fituar jetesën dhe për të shijuar jetën.<sup>28</sup>

Plan i ri i Veprimit për Shëndetin Mendor synon të përtërijë angazhimet e MSHMS-së për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor të popullatës drejt Mbulimit Shëndetësor Universal nëpërmjet ndërhyrjeve të integruara shëndetësore dhe sociale në përgjigje të sfidave shëndetësore të tashme dhe të ardhme, si dhe bazuar në mësimet e nxjerra në të kaluarën.

Ky dokument është hartuar në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi për kujdesin shëndetësor, shëndetin mendor dhe shërbimet përkatëse, si edhe angazhimeve ndërkombëtare të ndërrmarra nga ratifikimi i së drejtës ndërkombëtare për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore, duke u përqendruar në aftësinë e kufizuar dhe grupet e prekshme të popullatës, si fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë.

Ky dokument është në përputhje me angazhimet e Qeverisë Shqiptare në procesin e Integritimit Evropian.

## VIZIONI

Shëndet mendor pozitiv dhe mirëqenie personale për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë.

## QËLLIMI

Ky Plan synon të promovojë kujdesin për shëndetin mendor dhe mirëqenien e çdo qytetari në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet përkujdesjes shëndetësore dhe sociale ndaj çrregullimeve të shëndetit mendor, gjatë gjithë ciklit të jetës, nëpërmjet programeve të integruara socio-shëndetësore, parandalimit dhe ndërgjegjësimit të grupeve të cenushme dhe zhvillimit të sistemeve të informacionit dhe kërkimit shkencor.

## PARIMET

Plan i ri i Veprimit mbështetet në parimet e mëposhtme:

- Mbulim shëndetësor universal**  
Pavarësisht nga mosha, gjinia, statusi socio-ekonomik, raca, përkatësia etnike ose orientimi seksual dhe duke ndjekur parimin e barazisë, personat me çrregullime mendore duhet të kenë qasje në shërbimet bazë shëndetësore dhe sociale, që u mundësojnë atyre të realizojnë rimëkëmbjen dhe standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit.

28 OBSH.Shëndeti mendor. 2016. <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs220/en/>. Referimi për termat dhe perkufizimet Copenhagen: WHO Regional Office for Europe; 2016 (<http://www.euro.who.int/en/health-topics/noncommunicable-diseases/mental-health/key-terms-and-definitions-in-mental-health#health>)

## 2. Të drejtat e njeriut dhe gjithëpërfshirja

Strategjitë, veprimet dhe ndërhyrjet në shëndetin mendor për trajtim, parandalim dhe promovim duhet të jenë në përputhje me konventat për të drejtat e njeriut të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe kuadrin ligjor dhe rregullator kombëtar në këtë fushë.

## 3. Praktikë e bazuar në prova

Strategjitë dhe ndërhyrjet e shëndetit mendor për trajtim, parandalim dhe promovim, duhet të bazohen në prova shkencore dhe/ose praktika më të mira, duke marrë parasysh edhe kontekstin kulturor.

## 4. Qasje e integruar gjatë gjithë jetës

Politikat, planet dhe shërbimet për shëndetin mendor duhet të marrin parasysh nevojat shëndetësore dhe ato sociale në të gjitha fazat e jetës, duke përfshirë foshnjërinë, fëmijërinë, adoleshencën, rininë, moshën madhore dhe moshën e tretë.

## 5. Qasja socio-shëndetësore dhe ndërsektoriale

Një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar për shëndetin mendor kërkon integrim më të mirë të ndërhyrjeve shëndetësore me ato sociale, por edhe një partneritet me sektorë të shumtë publikë, si: arsimi, punësimi, gjyqësori, strehimi, si dhe me sektorin privat apo jopublik.


## 6. Fuqizimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe aftësi të kufizuara mendore

Personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe aftësi të kufizuara mendore duhet të fuqizohen dhe mbështeten për jetesë të pavarur dhe për të kontribuar në komunitetin ku jetojnë.

## 7. Ndërhyrje me ndjeshmëri gjinore

Dokumenti strategjik për shëndetin mendor duhet të sigurojë ndjeshmërinë e duhur gjinore, duke përfshirë ndërhyrje të orientuara ndaj nevojave të veçanta të të dy gjinive.

Realizimi i qëllimit të këtij dokumenti synohet të arrihet nëpërmjet zbatimit të 4 Objektivave Strategjike.



## Objektivi strategjik 1:

Zhvillimi i shërbimeve të shëndetit mendor me fokus mbulimin shëndetësor universal

**Rezultatet e pritshme:** Tipologjitë e shërbimeve të shëndetit mendor në të gjitha nivelet e ofrimit të këtij shërbimi janë përmirësuar; kategoritë e ndjeshme të popullatës janë identifikuar dhe janë vënë në fokus; burimet njerëzore janë përmirësuar; infrastruktura është zgjeruar edhe përmes angazhimit të pushtetit vendor; sistemi i të dhënave në nivel kombëtar ofron mundësi për punë kërkimore dhe studime, duke iu përgjigjur nevojave komplekse të popullatës për shërbime të integruara socio-shëndetësore gjatë gjithë jetës.

Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor si pjesë e Kujdesit Shëndetësor Parësor është një nga drejtimet kryesore të zhvillimit strategjik të shërbimeve të shëndetit mendor drejt MSHU-së, pa lënë mënjanë ndikimin e pandemisë së Covid-19. Fuqizimi i dyanshëm i shërbimeve komunitare të specializuara në shëndet mendor së bashku me integrimin më të mirë të shërbimeve të shëndetit mendor në sistemin e kujdesit parësor (aftësimin e mjekut të përgjithshëm si dhe integrimin e shërbimeve psikosociale në këtë nivel shërbimesh) është i rëndësishëm për zbatimin e procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të këtyre shërbimeve, me qëllim garantimin e përkujdesjes gjatë gjithë jetës. Mbështetja e vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve ofruese të këtyre shërbimeve, nëpërmjet standardizimit të instrumenteve dhe protokolleve dhe mekanizmave të referimit, apo aktiviteteve të formimit të vazhdueshëm profesional në fushën e shëndetit mendor, (trajtimi, rimëkëmbja, parandalimi, respekti ndaj dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, etj.) janë elemente themelore për rritjen e qasjes dhe cilësisë në shërbimet e shëndetit mendor.

## Objektivi strategjik 2:

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe ripërtëritjes së shëndetit mendor të popullatës gjatë emergjencave (mësimet e nxjerra nga Pandemia Covid-19).

**Rezultatet e pritshme:** Kategoritë e ndjeshme të popullatës janë identifikuar dhe vendosur në fokus; burimet njerëzore janë përmirësuar përmes mbështetjes psikosociale dhe të shëndetit mendor; infrastruktura është zgjeruar përmes angazhimit të pushtetit vendor; kuadrin ligjor dhe administrativ është përmirësuar për të adresuar planet e emergjencës, me fokus shëndetin mendor; sistemi i të dhënave në nivel kombëtar ofron mundësi për punë kërkimore dhe studime.

Të dhëna tregojnë se përhapja e COVID-19 ndikoi rëndë në shëndetin mendor të popullsisë, duke shkaktuar shqetësim, stres dhe ankth. Personat që ishin të infektuar, por edhe kontaktet e tyre të ngushta, kishin një ankth më të shtuar prej rrezikut nga format më të rënda të sëmundjes, me ndikime më afatgjata apo me pasoja fatale. Është vërejtur se masat shtrënguese për të frenuar përhapjen e mëtejshme të sëmundjes, si izolimi, bllokimet dhe mbylljet e shkollave dhe vendeve të punës patën efekt në shëndetin mendor për shumë njerëz, të kundërt nga efekti për mbrojtje nga infektimi, veçanërisht mes fëmijëve dhe adoleshentëve. Megjithatë, ndikim më të madh pati tek personat me probleme të mëparshme të shëndetit mendor dhe ata me aftësi të kufizuara mendore.

Për më tepër, kontakti personal u kufizua shumë dhe u zëvendësua nga modalitete të mbështetjes në distancë; stafi dhe infrastruktura u riorganizuan dhe institucionet me shtretër u izoluan, për shkak të rrezikut të infektimit apo izolimit më të thellë. Ndikimet e pandemisë kanë filluar të ndihen në rritjen e kërkesës për mbështetje psikosociale dhe kujdes për shëndetin mendor, veçanërisht në grupet më të cënueshme të shoqërisë që u prekën më shumë nga ndërhyrjet kufizuese, si fëmijët, adoleshentët, të rinjtë, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, etj. Ky Plan Veprimi synon të trajtojë këto problematika duke sjellë në vëmendje përgatitjet për plane ndërhyrjeje që lidhen me përballjen dhe rimëkëmbjen pas emergjencave.

Në fokus të ndërhyrjeve është edhe përmirësimi i shëndetit mendor dhe mbështetja psikosociale e vetë ofruesve të shërbimeve shëndetësore dhe sociale, në përballjen me emergjenca të natyrave të ndryshme.

Kuadri rregullator, protokollat e ndërhyrjes dhe planet e trajtimit dhe ndjekjes kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve të burimeve njerëzore (ofruesve të drejtëpërdrejtë të shërbimeve), për adresimin e masave të emergjencës.

### Objektivi strategjik 3:

**Promovimi, mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin mendor të popullatës gjatë gjithë ciklit të jetës.**

**Rezultatet e pritshme:** Komunitete më të vetëdijshme dhe me aftësi ripërtëritëse për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies, si dhe për qasjen dhe përdorimin e duhur të shërbimeve të shëndetit mendor; numri i shtuar i sektorëve të ndryshme të përfshirë në promovimin e shëndetit mendor dhe ndërhyrjeve ndërgjegjësuuese, si dhe i provave për shëndetin mendor të popullatës; kategoritë e cënueshme të popullatës të identifikuar dhe të vendosura në fokus.

Shëndeti ka disa komponentë, pavarësisht perceptimit të ngushtë që lidhet me praninë ose mungesën e një sëmundjeje, dhe në morinë e këtyre komponentëve, një rol specifik luan komponenti i shëndetit mendor. Shëndeti mendor dhe mirëqenia personale vihen në rrezik nga një sërë faktorësh individualë, socialë dhe mjedisorë, duke përfshirë varfërinë, papunësinë, përjashtimin social, dhunën, konfliktet dhe emergjencat e natyrave të ndryshme, si në rastin e pandemisë së SARS-CoV-2 (COVID-19). Ndërhyrjet strategjike për promovimin dhe mbrojtjen e tij duhet të zbatohen në nivel horizontal, me qasje ndërsektoriale dhe në nivel vertikal nga sistemet tek individit.

Ndërhyrjet në promovimin e shëndetit mendor duhet të kenë qasje gjithëpërfshirëse, të mbështetura tek personi e për pasojë, të orientuara nga nevojat për kujdes shëndetësor në shëndetin mendor për të garantuar mundësi dhe burime të barabarta, respektim të të drejtave themelore, dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Kjo përfshin krijimin e një mjedisi mbështetës, përmirësimin e qasjes në informacion dhe zhvillimin e aftësive dhe mundësive për të bërë zgjedhje të shëndetshme. Njerëzit nuk mund ta arrijnë potencialin e tyre të plotë shëndetësor nëse ata nuk janë në gjendje të kenë kontroll mbi elementet që përcaktojnë shëndetin e tyre. Gjithashtu përfshirja e shërbimeve të shëndetit mendor dhe përfitimet e qasjes në shërbimet parandaluese dhe trajtuese përbën një nga shtyllat kryesore të ndërhyrjeve për ruajtjen e një shëndeti sa më të mirë mendor.

### Objektivi strategjik 4:

**Zhvillim i mëtejshëm i kuadrit rregullator dhe praktikës të lidhur me shëndetin mendor, në dritën e të drejtave të njeriut dhe mekanizmave monitoruese dhe qeverisëse të shërbimeve të shëndetit mendor**

**Rezultatet e pritshme:** Shërbime të shëndetit mendor të standardizuara dhe ofrues shërbimesh të fuqizuar me instrumente të standardizuara, mbështetur nga mekanizma të përmirësuar monitorimi dhe një qeverisje dhe advokim më të mirë në këtë fushë, në përgjigje të qasjes gjithëpërfshirëse dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për zhvillimin e shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor përmes tipologjive të reja me bazë komunitare dhe profileve të shtuara profesionale është identifikuar nevoja për standartizimin e shërbimeve dhe praktikave profesionale, në një linjë me riorganizimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe me zhvillimet e fundit në KSHP. Këto role ndihmëse do të kontribuojnë në përmirësimin e identifikimit, referimit dhe ndjekjes në vazhdimësi të rasteve specifike dhe përmirësimin e shërbimit të kujdesit psikosocial. Gjithashtu, riorganizimi dhe fuqizimi i mekanizmave monitorues dhe qeverisës, në nivel qëndror dhe vendor, edhe nëpërmjet fuqizimit të aftësive advokuese në këtë fushë, do të kontribuojnë në përmirësimin e performancës së shërbimeve të shëndetit mendor dhe për rrjedhojë në rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe standardizimit të shërbimeve ndërsektoriale për shëndetin mendor dhe mbështetjes psikosociale për fëmijët dhe adoleshentët, nëpërmjet rrugëve të qarta të referimit, me qëllim përmirësimin e ofrimit të këtij shërbimi.

### Përshkrimi i objektivave specifike dhe masave për arritjen e objektivave strategjike:

#### Objektivi strategjik 1:

**Zhvillimi i shërbimeve të shëndetit mendor me fokus mbulimin shëndetësor universal**

##### Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i shërbimeve të shëndetit mendor në KSHP

###### Treguesit:

- Udhërrëfyësi për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP i miratuar.
- 6 trajnerët e parë të trajnuar për trajnim trajnerësh për zbatimin e udhërrëfyesit;
- Programi i trajnimit i akredituar;
- 100% e mjekëve të përgjithshëm, mjekëve të familjes dhe infermierëve të mjekësisë së familjes të trajnuar për zbatimin e udhërrëfyesit të ri për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP;
- 2 trajnime me mjekët e përgjithshëm për diagnostikimin dhe menaxhimin e depresionit dhe ankthit;
- Një trajnim dy-ditor i organizuar;

- Të paktën 100 infermierë të aftësuar për ofrimin e shërbimit në banesë, për të moshuarit, me fokus edhe problemet e shëndetit mendor;
- Të paktën 6 takime në 6 qarqet ku janë ngritur dhe funksionojnë QKSHM-të, të organizuara;
- 100 profesionistë psikosocialë të atashuar pranë QSH-ve brenda vitit 2023;
- 100% e QSH-ve të pajisura me staf psikosocial;
- Të paktën 12 takime lokale mes ofruesve të shërbimeve të shëndetit mendor të parësorit dhe të shërbimeve komunitare të specializuara të shëndetit mendor si dhe përfaqësues të qeverisjes vendore - të organizuara;

#### Masat:

- 1.1.1 Zhvillimi i paketës për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP me qëllim fuqizimin e integritetit të shëndetit mendor në këtë nivel shërbimesh;
- 1.1.2 Fuqizimi i kapaciteteve të mjekëve të përgjithshëm dhe infermierëve për identifikimin, trajtimin, referimin në kohë dhe ndjekjen e vazhdueshme të problemeve të shëndetit mendor, në nivel kombëtar, sipas paketës së zhvilluar për këtë qëllim dhe nëpërmjet trajnimeve kaskadë, të akredituara;
- 1.1.3 Rifreskimi i vazhdueshëm i njohurive dhe kapaciteteve të personelit të kujdesit shëndetësor parësor në menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP;
- 1.1.4 Fuqizimi i kapaciteteve të stafeve që ofrojnë shërbimin shëndetësor në banesë, edhe për të moshuarit, me fokus shëndetin e tyre mendor;
- 1.1.5 Informimi mbi problematikat e shëndetit mendor për grupet e cënueshme, me fokus të veçantë të moshuarit, pjesë e shërbimit në banesë në KSHP, në të gjitha qarqet ku janë ngritur dhe funksionojnë shërbimet e specializuara të shëndetit mendor;
- 1.1.6 Shtrirja dhe fuqizimi i shërbimit psikosocial në KSHP dhe përmirësimi i ndërveprimit me shërbimet e specializuara të shëndetit mendor;

#### Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë

##### Treguesit

- 100 % e mjekëve të Konsultorit të Fëmijës të trajnuar për zbatimin e protokolleve të përditësuara për shëndetin mendor;
- 100% e infermierëve të Konsultorit të Fëmijës të trajnuar për zbatimin e protokolleve të përditësuara për shëndetin mendor;
- Të paktën 4 ekipe të reja multidisiplinare për fëmijët dhe adoleshentët, shtohen dhe funksionojnë pranë QKSHM-ve të ngritura në nivel qarku (Tiranë, Korçë, Vlorë dhe Berat);
- 5 ditë trajnim i 4 ekipeve të reja për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve të trajnuar pranë QKSHM-ve që ofrojnë këtë shërbim;
- Të paktën një trajnim i organizuar për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP;
- 100% e stafeve shëndetësore të trajnuar, në një qark të caktuar, për kujdesin e grave pas lindjes (post-partum) që kanë nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor;
- Paketa e shërbimeve të shëndetit mendor, mirëqenies psikosociale dhe e zhvillimit për fëmijët dhe adoleshentët në KSHP e rishikuar;
- Paketa e shërbimeve të shëndetit mendor, mirëqenies psikosociale dhe e zhvillimit për fëmijët dhe adoleshentët në nivel QKSHM e rishikuar;
- Paketa e shërbimeve të shëndetit mendor, mirëqenies psikosociale dhe e zhvillimit për fëmijët dhe adoleshentët në nivel arsimit parauniversitar e rishikuar;
- Udhëzues për rrugët e referimit i hartuar;
- Protokolle pune të hartuara;
- Rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat e secilit profesionist të hartuara;

- Studim fizibiliteti për ngritjen e Qendrave Rajonale Terapeutike dhe Rehabilituese të ngritura (në Elbasan ose Vlorë), sipas modelit të QKTRF-së;
- Të paktën 10 trajnime të zhvilluara për stafet shëndetësore në ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe këshillave për prindërim pozitiv;
- Paketa e trajnimit e zhvilluar për ofrimin e shërbimeve të integruara për shëndetin mendor dhe mirëqenien dhe zhvillimin psikosocial të fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre;
- 1 seancë trajnim trajnerësh i organizuar për ofrimin e shërbimeve të integruara për shëndetin mendor dhe mirëqenien dhe zhvillimin psikosocial të fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre;
- Trajnim kaskadë i realizuar për ofrimin e shërbimeve të integruara për shëndetin mendor dhe mirëqenien dhe zhvillimin psikosocial të fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre;
- Mbikëqyrje e stafeve të aftësuara për ofrimin e shërbimeve të integruara për shëndetin mendor dhe mirëqenien dhe zhvillimin psikosocial të fëmijëve-adoleshentëve dhe familjeve të tyre;
- Udhëzuesi për ofruesit jo-profesionistë dhe kujdestarët mbi strategjitë për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe reduktimin e vetëdëmtimit dhe rreziqeve të tjera, bazuar në manualin e OBSH-së dhe UNICEF-it, "Helping adolescents thrive toolkit" ("Të ndihmojnë adoleshentët të ecin përpara") i miratuar;
- Udhëzuesi për mësuesit "Teacher's Guide and Comic Book" ("Udhëzues për mësuesin dhe libër vizatimor") pjesë e paketës "Helping adolescents thrive toolkit", të OBSH-së dhe UNICEF-it, i përshtatur dhe zbatuesit e tij të informuar;

#### Masat

- 1.2.1 Përmirësimi i punës së Konsultorit të Fëmijës, në KSHP, në lidhje me identifikimin, referimin dhe ndjekjen e probematikave të shëndetit mendor, veçanërisht për grup-moshën 0-6 vjeç, në zbatim të protokolleve të përditësuara;
- 1.2.2 Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve ekzistuese të shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët, të ofruara nga QKSHM-të, përfshirë aftësitë për të identifikuar, trajtuar dhe referuar raste me probleme të shëndetit mendor, si problemet e zhvillimit dhe të sjelljes në fëmijët dhe adoleshentët, si dhe rastet me mendime për vetëdëmtim mes adoleshentëve.
- 1.2.3 Zbatimi i seancave për shkëmbimin e eksperiencës mes ekipeve të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor;
- 1.2.4 Rifreskimi i njohurive të stafeve shëndetësore të Konsultorit të Fëmijës në KSHP, në lidhje me identifikimin, referimin dhe ndjekjen e probematikave të shëndetit mendor, veçanërisht për grup-moshën 0-6 vjeç, në zbatim të protokolleve të përditësuara, pjesë e paketës së edukimit të detyrueshëm shëndetësor;
- 1.2.5 Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në KSHP për ofrimin shërbimeve të shëndetit mendor dhe mirëqenies psikosociale për gratë pas lindjes (post-partum) me probleme të shëndetit mendor, duke pasur në konsideratë edhe statusin e tyre si kujdestare të fëmijëve të porsalindur;
- 1.2.6 Forcimi i sistemit të kujdesit për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe mirëqenies e zhvillimit psikosocial të fëmijëve-adoleshentëve dhe familjeve të tyre, të integruara, të arritshme dhe miqësore më fëmijët, përfshirë shërbimet e specializuara të shëndetit mendor me bazë komunitare, kujdesin shëndetësor parësor, shërbimet psikosociale të arsimit parauniversitar, etj.;
- 1.2.7 Zhvillimi i rrugëve të integruara ndërsektorale për identifikimin, trajtimin, kujdesin dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë për mbështetje psikosociale dhe në shëndet mendor, përfshirë udhëzues për rrugët e referimit, protokolle pune, rregullat e referimit, rolet dhe përgjegjësitë e secilit profesionist, kompetencat, etj.;
- 1.2.8 Shtrirja në nivel rajonal e modelit të shërbimit të ofruar nga QKTRF;



- 1.2.9 Rritja e kapaciteteve të punonjësve shëndetësorë për t'u ofruar prindërve dhe kujdestarëve të tjerë mbështetje psikosociale dhe prindërim pozitiv;
- 1.2.10 Zhvillimi i një pakete trajnimi për profesionistët që ofrojnë kujdes dhe trajtim për fëmijët dhe adoleshentët në nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor;
- 1.2.11 Zhvillimi i kapaciteteve për kujdesin e fëmijëve dhe adoleshentëve që kanë nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor, në një qark të identifikuar paraprakisht nga trajnimi i trajnerëve, mbikëqyrja e mbështetur, trajnimet nëpërmjet trajnerëve të formuar dhe ndjekja në vazhdim;
- 1.2.12 Përshtatja, testimi dhe përfundimi i një udhëzuesi për ofruesit jo-profesionistë dhe kujdestarët mbi strategjitë për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor të adoleshentëve dhe reduktimin e vetëdëmtimit dhe rreziqeve të tjera, bazuar në manualin e OBSH-së dhe UNICEF-it, "Helping adolescents thrive toolkit";
- 1.2.13 Përshtatja dhe përdorimi në shkollë, si pjesë e programeve të promovimit të shëndetit mendor të "Teacher's Guide and Comic Book", pjesë e "Helping adolescents thrive toolkit", të OBSH-së dhe UNICEF-it, me qëllim lehtësimin e të kuptuarit dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme të shëndetit mendor.

**Objektivi specifik 1.3: Përsheptimi i procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të shëndetit mendor duke zhvendosur me shpejtësi burimet drejt shërbimeve socio-shëndetësore komunitare të shëndetit mendor**

**Treguesit:**

- 10 QKSHM-të dhe 14 shtëpitë e mbështetura vazhdojnë të mbështeten financiarisht për funksionimin e tyre të plotë;
- Grup pune për mënyrën e menaxhimit të të ardhurave dytësore të QKSHM-ve;
- Të paktën 4 QKSHM të ngritura dhe funksionale në qarqet më të mëdha të vendit;
- 8 seanca trajnimi (5 ditore) të organizuara në shërbimet komunitare të shëndetit mendor ekzistuese, për aftësimin e stafeve të reja multidisiplinare të shërbimeve të reja komunitare;
- Shërbimeve të shëndetit mendor me shtretër ju sigurohet mbështetje financiare për funksionim të plotë;
- Ambientet e Spitalit Psikiatrik Vlorë ku akomodohen dhe trajtohen pacientët rezidentë kronikë, të rikonstruara dhe të mobiluara;
- Projekti preventiv për rikonstrukcionin e Spitalit Psikiatrik Elbasan i realizuar;
- Rikonstrukcioni dhe pajisjet e hotelarisë dhe ato industriale të Spitalit Psikiatrik Elbasan të realizuara;
- Rikonstrukcioni i Shërbimit Psikiatrik, pranë QSUT i realizuar;
- Ngritja e të paktën 4 (katër) shtëpive të mbështetura për rehabilitimin e personave me çrregullime kronike të shëndetit mendor të referuar nga komuniteti;
- Projektfizibiliteti për ngritjen e një pavion psikiatrik/shërbimi të shëndetit mendor më shtretër në një spital rajonal, i realizuar;
- Projektpropozimi (Action Fiche) dhe Dokumenti i Veprimit (Action Document) për ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm për financim nga IPA, i hartuar, në përgjigje edhe të rekomandimeve të autoriteteve monitoruese kombëtare (AP, KMD, etj.) dhe ndërkombëtare (CPT);
- Të paktën 3 (tri) takime në vit, të ekipeve shëndetësore dhe strukturat e shërbimeve sociale të njësisë të vetëqeverisjes vendore, me fokus shërbimin në banesë për personat me çrregullime të shëndetit mendor, të organizuara, koordinuar nga sektorët e shëndetit mendor pranë NJVKSH-ve;

- 2 (dy) apartamente të mbështetura (me kapacitet 3-4 persona/secila) të ngritura dhe funksionale, pranë shtëpive mbështetëse të Kavajës dhe Tiranës, për përgatitjen për jetesë të pavaruar të personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë përfituar nga shërbimi rehabilitues i shtëpive të mbështetura;
- 6-8 persona përfitojnë shërbime të jetesës së pavarur në apartamentet e mbështetura;
- 2 (dy) grupe teknike ndërsektoriale (NJVV, DRSHSSH, Drejtoritë Rajonale të Punësimit dhe Arsimit Profesional, etj., sipas nevojave të identifikuar) të ngritura dhe funksionale nën koordinimin e NJVKSH-ve përkatëse (Tiranë dhe Kavajë), DROSHKSH Tiranë, për ofrimin e shërbimeve që mundësojnë jetesën e pavaruar;
- Të paktën 6 seanca psikoedukimi për kujdestarët/asistentët personalë dhe familjarët e personave me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor, përfitues të shërbimit të apartamenteve të mbështetura, nëpërmjet informimit për identifikim e nevojave për shërbime socio-shëndetësore dhe fuqizimit të aftësive advokuese për këta persona;
- Ofrimi i shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve psikiatër, i siguruar;
- Ekzaminimet e ndryshme kliniko-biokimike, imazherike, konsulta të specializuara, etj. dhe trajtimi i specializuar (ndërrhyrje kirurgjikale, etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, të ofruara nga shërbimet shëndetësore;
- Shërbimet e shëndetit publik të ofruara sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë.

**Masat:**

- 1.3.1 Sigurimi i vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve komunitare të shëndetit mendor;
- 1.3.2 Fuqizimi i autonomisë financiare të QKSHM-ve në lidhje me menaxhimin e të ardhurave dytësore nga vetë këto shërbime në funksion të përmirësimit të kushteve dhe ndërrhyrjeve rehabilituese të ofruara nga vetë ato;
- 1.3.3 Pasurimi i rrjetit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor (QKSHM), kryesisht në qarqet e mëdha të vendit;
- 1.3.4 Fuqizimi i kapaciteteve të stafeve të reja multidisiplinare mbi tipologjitë e shërbimeve komunitare të shëndetit mendor me bazë;
- 1.3.5 Sigurimi i vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve me shtretër të shëndetit mendor;
- 1.3.6 Rirorganizimi i shërbimit rezidencial (rezidentëve kronikë) të spitaleve psikiatrike në funksion të ofrimit të një shërbimi rehabilitues sa më dinjitoz dhe të individualizuar;
- 1.3.7 Përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, në respekt të dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut;
- 1.3.8 Mbështetja me shërbime rehabilituese të ofruara në formën e shtëpive mbështetëse për personat me çrregullime kronike të shëndetit mendor të referuar nga komuniteti;
- 1.3.9 Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor me shtretër në shërbimet e përgjithshme shëndetësore, nëpërmjet pilotimit të shtretërve psikiatrikë/pavioneve psikiatrike (akut/subakut) pranë një spitali rajonal;
- 1.3.10 Përmirësimi i shërbimeve të trajtimit dhe rehabilitimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, në përmbushje të standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të autoriteteve monitoruese kombëtare (AP, KMD, etj.) dhe ndërkombëtare (CPT), dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- 1.3.11 Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat e shërbimeve sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me fokus shërbimet komunitare për personat me çrregullime të shëndetit mendor;



- 1.3.12 Pilotimi i shërbimit të mbështetjes për jetesë të pavarur dhe të vendimtarjes së mbështetur të personave me aftësi të kufizuar mendore dhe mbështetjes së duhur për kujdestarët/asistentët personalë dhe familjarëve të personave me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor;
- 1.3.13 Ofrimi i shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve, sipas nevojave;
- 1.3.14 Sigurimi i diagnostikimit (ekzaminimeve kliniko-biokimike, imazherike, konsultave të specializuara, etj.) dhe trajtimit të specializuar (ndërrhyrje kirurgjikale, etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, nëpërmjet Spitalit Rajonal Lezhë dhe strukturave të tjera spitalore univeritare;
- 1.3.15 Ofrimi i ekzaminimeve laboratorike, depistimeve epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë;

#### **Objektivi specifik 1.4: Zhvillim i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve socio-shëndetësore në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor**

##### **Treguesit:**

- Të paktën 8 mjekë ndjekin specializimin në psikiatrinë për adultë dhe 4 për psikiatrinë për fëmijë dhe adoleshentë, si kuota të mbuluara nga MSHMS;
- Kurrikula universitare të mjekësisë dhe infermierisë të përditësuara për çështjet e shëndetit mendor;
- Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, Shtëpitë e Mbështetura me praktikën më të mirë, si dhe QSH-të me shërbimin më të mirë psikosocial ofrojnë praktika universitare;
- Të paktën 300 stafe multidisiplinare të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor të trajnuar sipas "WHO QualityRights" ("Të drejtat e barazisë sipas OBSH-së");
- Procedurat Standarde dhe Mjetet e Vlerësimit të Shëndetit Mendor për ekstremistët e dhunshëm, duke u fokusuar veçanërisht te të burgosurit e liruar në rrezik radikalizimi, janë projektuar/përmirësuar dhe pilotuar me sukses;
- Manual/udhëzues për shëndetin mendor të viktimave të trafikimit dhe dhunës dhe abuzimit, i hartuar;
- Manual/udhëzues për shëndetin mendor të migrantëve, i hartuar;
- 12 trajnime multisektorale në 12 qarqet e vendit mbi shëndetin mendor të grupeve të cënueshme (viktimat e trafikimit, ekstremizmit të dhunshëm, viktimat e dhunës dhe abuzimit, flukset mikse migratore, etj.), të realizuara;
- 100% e QSH-ve me shërbim psikosocial të integruar nëpërmjet atashimit të stafeve psikosociale në këtë nivel shërbimesh dhe kualifikimit të tyre për trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor;
- 100% e stafeve sociale të NJVV-ve janë informuar mbi problematikat socio-ekonomike të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe shërbimet nëpërmjet të cilave këto problematika mund të trajtohen;
- Kriteret për kryerjen e një vlerësimi të riskut, të përcaktuara dhe klasifikimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, i realizuar;
- Asistencë në hartimin e planeve individuale të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, e siguruar;
- Programet rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të zhvilluara;

- 100% e ofruesve të programeve rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të trajnuar për zbatimin e tyre;
- Kurrikulat e trajnimit në vendin e punës për ofrimin e shërbimit psikiatrik për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të hartuara;
- 100% e stafeve klinike të trajnuar për ofrimin e shërbimeve multidisiplinare për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.

##### **Masat:**

- 1.4.1 Vazhdimi i politikës së hapjes së specializimeve dhe ruajtja e kuotave vjetore në specializimet për psikiatrinë për adultë dhe për fëmijët dhe adoleshentët, si kuota të mbuluara nga MSHMS;
- 1.4.2 Pasurimi i kurrikulave universitare të mjekësisë dhe infermierisë me module me fokus të veçantë në shëndetin mendor komunitar;
- 1.4.3 Zgjerimi dhe pasurimi i shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor ku realizohet praktika universitare e mjekësisë dhe infermierisë së përgjithshme;
- 1.4.4 Përmirësimi i qëndrimeve dhe praktikave në shëndetin mendor nëpërmjet zbatimit të një qasjeje të bazuar në të drejtat dhe të orientuar drejt rimëkëmbjes të shërbimeve të shëndetit mendor, sipas parimeve të OBSH-së "WHO QualityRights";
- 1.4.5 Përmirësimi i njohjes dhe trajtimit, nga ana e ofruesve të shërbimeve të shëndetit mendor, të problematikave të shëndetit mendor të grupeve të cënueshme, si: viktimat e trafikimit, ekstremizmit të dhunshëm, viktimave të dhunës dhe abuzimit, flukseve mikse migratore, etj.
- 1.4.6 Ngritja dhe fuqizimi i shërbimit psikosocial në KSHP, në kuadër të integritimit socio-shëndetësor;
- 1.4.7 Rritja e kapaciteteve të stafeve sociale të NJVV-ve për identifikimin e nevojave socio-ekonomike të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe referimin në shërbime, sipas kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të parimeve të gjithpërfshirjes, mosdiskriminimit dhe respektit për të drejtat themelore të njeriut;
- 1.4.8 Klasifikimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore sipas nivelit të rrezikut nga stafe të kualifikuara mbi këto procedura;
- 1.4.9 Zbatimi i ndërhyrjeve të strukturuar dhe në përgjigje të nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore nëpërmjet hartimit të planeve individuale të trajtimit;
- 1.4.10 Përmirësimi i ndërhyrjeve rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore; Mbështetja e stafeve klinike për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.

#### **Objektivi specifik 1.5: Digjitalizimi i shërbimeve të shëndetit mendor dhe përmirësimi i informacionit lidhur me shëndetin mendor si nevojë për vendimmarrje në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve**

##### **Treguesit:**

- 100% e shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor janë përfshirë në sistemet shëndetësore digjitale;
- 100% e stafeve përdoruese të sistemeve elektronike të trajnuara;

- Të gjitha stafet psikosociale prane QKSHM-ve bëjnë një vlerësim paraprak, orientojnë dhe mbështesin qasjen në shërbimin online nëpërmjet instrumentit "ifightdepression";
- Stafet psiko-social i QSH-ve e njej instrumentin "ifightdepression" dhe e përdor atë;
- Praktikave e mira të dokumentuara dhe rekomandime të nxjerra për mbështetjen e një platforme online shërbimesh për adoleshentët në nevojë për mbështetje psikosociale dhe në shëndet mendor;
- Faqet zyrtare dhe mediat sociale të ISHP-së dhe 36 NJVKSHV-ve të pasuruara me informacion të përditësuar për shëndetin mendor;
- Baza e të dhënave që raportohen nga shërbimet e specializuara të shëndetit mendor, e përditësuar;
- Të dhënat për shëndetin mendor, të mbledhura nga sistemi i kujdesit parësor dhe të aksesueshme;
- Linja kombëtare e këshillimit online për problemet e shëndetit mendor është funksionale;
- Mjetet digjitale të vetëndihmës, të prezantuara tek grupet më të cenueshme dhe në rrezik më të lartë për probleme të shëndetit mendor.

**Masat:**

- 1.5.1 Zhvillimi i digjitalizimit edhe në shërbimet e specializuara të shëndetit mendor, pjesë e projekteve të digjitalizimit të shërbimeve shëndetësore;
- 1.5.2 Rritja e qasjes në formatet online të shërbimeve për shëndetin mendor dhe promovimi i praktikave të mira në lidhje me e-mental health (instrumenti "ifightdepression");
- 1.5.3 Mbështetja e një platforme online shërbimesh për adoleshentët në nevojë për mbështetje psikosociale dhe shëndet mendor;
- 1.5.4 Pasurimi i faqeve apo rrjeteve zyrtare të komunikimit të institucioneve kryesore të shëndetësisë (ISHP, NJVKSH) në fushën e promovimit të shëndetit mendor, me fokus të veçantë grupet më të cenueshme (burimi i mundshëm Koalicionin Pan-Evropian për Shëndetin Mendor);
- 1.5.5 Përmirësimi i informacionit dhe treguesve thelbësorë për shërbimet e specializuara të shëndetit mendor drejt digjitalizimit të këtij sistemi;
- 1.5.6 Zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve digjitale në KSHP, me në qendër individin dhe kartelën e tij elektronike shëndetësore me qëllim edhe rritjen e transparencën në komunikimin me publikun për gjendjen e shëndetit të popullatës, edhe shëndetin mendor, duke përdorur burimet e disponueshme;
- 1.5.7 Ngritja dhe funksionimi i një linje kombëtare të këshillimit online për problemet e shëndetit mendor (financuar nga Fondi Social).
- 1.5.8 Prezantimi i mjeteve digjitale vetëndihmëse (si MENTINA apo "ifightdepression") mes grupeve të cenueshme me rrezik të shtuar për probleme të shëndetit mendor, duke synuar kryesisht të rinjtë, adultët, të papunët, etj.

**Objektivi strategjik 2:**

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe ripërtëritjes së shëndetit mendor të popullatës gjatë emergjencave (mësimet e nxjerra nga Pandemia Covid-19).

**Objektivi specifik 2.1: Konsolidimi i kuadrit kombëtar të gatishmërisë ndaj emergjencave, me komponentin e shëndetit mendor dhe mbështetjes psikosociale, përgjigjja ndaj emergjencave dhe rikuperimi pas tyre**

**Treguesit:**

- Plani i emergjencave i rishikuar dhe pasuruar me komponentin e SHMPS-së;
- Të paktën 4 (katër) takime informuese rajonale, prane DROSHKSH-ve, me specialistë të shëndetit mendor pranë NJVKSH-ve mbi parashikimet e reja të kuadrit të emergjencave, të organizuara;
- Të paktën 36 takime me stafet multidisiplinare të shëndetit mendor dhe parësorit mbi kuadrin e ri të emergjencave, të organizuara;
- 10 takime kombëtare për ndikimin e emergjencave në popullatat e prekshme/të cenueshme, të organizuara;
- Rregullorja e shërbimeve të shëndetit mendor përmban parashikime për shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale në raste emergjencash.

**Masat:**

- 2.1.1 Rishikimi i planit të emergjencave dhe integrimi i ndërhyrjeve të shëndetit mendor dhe mbështetjes psikosociale;
- 2.1.2 Informimi i specialistëve pranë DROSHKSH/NJKSH për kuadrin e ri kombëtar të gatishmërisë ndaj emergjencave shëndetësore;
- 2.1.3 Informimi i stafeve multidisiplinare të shëndetit mendor dhe parësorit për kuadrin e ri kombëtar të gatishmërisë ndaj emergjencave shëndetësore;
- 2.1.4 Informimi mbi ndikimin e emergjencave, veçanërisht në popullatat më të prekshme/cenueshme;
- 2.1.5 Zhvillimi i akteve rregullatore, në plotësim të ndërhyrjeve në situata emergjencash.

**Objektivi specifik 2.2: Fuqizimi dhe përmirësimi i shëndetit mendor dhe aftësive ripërtëritëse të punonjësve shëndetësorë që përballen me emergjencat**

**Treguesit**

- 36 njësi për shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale, të ngritura dhe trajnuara;
- 1000 profesionistë shëndetësorë të trajnuar për përmirësimin e shëndetit mendor dhe aftësive ripërtëritëse të tyre në përballjen me emergjencat shëndetësore;

**Masat:**

- 2.2.1 Formalizimi i njësive (në përbërje të të cilave janë TiT të formuar, sektori i shëndetit mendor në NJVKSH, stafi psikosocial në KSHP, etj.) për mbështetjen në shëndetin mendor dhe psikosocial të profesionistëve shëndetësorë në rast emergjencash shëndetësore;
- 2.2.2 Trajnime kaskadë të punonjësve shëndetësorë mbi përmirësimin e shëndetit mendor dhe aftësive ripërtëritëse të tyre në përballjen me emergjencat shëndetësore, të organizuara sipas paketës së akredituar;

**Objektivi specifik 2.3: Mbështetja e shëndetit mendor të grupeve të cenueshme gjatë emergjencave (si personat me çrregullime/probleme ekzistuese të shëndetit mendor, fëmijët dhe adoleshentët jashtë shkollave, të moshuarit e izoluar në banesat e tyre, refugjatët dhe migrantët, etj.) si dhe rritja e qëndrueshmërisë së profesionistëve shëndetësorë**

**Treguesit**

- 4 udhëzues të hartuar/rishikuar për kategoritë më të cenueshme;
- 1000 punonjës së linjës së parë të trajnuar në ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe shëndetit mendor gjatë emergjencave, sipas paketës së OBSH-së dhe UNICEF-it;
- 100 profesionistë psikosocialë të KSHP-së të trajnuar për çështje të shëndetit mendor të punonjësve shëndetësorë në përballjen me emergjencat;

**Masat:**

- 2.2.1 Hartimi i udhëzuesve specifikë për ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe shëndetit mendor për grupet e cenueshme gjatë emergjencave (qendrat e zhvillimit 0-21 vjeç, shtëpitë e fëmijëve sipas grup-moshave, qendrat rezidenciale për të rinjtë, qendrat rezidenciale për të moshuarit, shërbime të specializuara të shëndetit mendor më mbështetje 24/7);
- 2.2.2 Organizimi i trajnimeve të stafëve që ofrojnë shërbime për grupet e cenueshme lidhur me mbështetjen psikosociale dhe në shëndet mendor;
- 2.2.3 Trajnimi i stafëve psikosociale të KSHP-së dhe të shërbimit spitalor për përmirësimin e shëndetit mendor dhe aftësive ripërtëritëse të punonjësve shëndetësorë në përballjen me emergjencat shëndetësore, sipas paketës së akredituar, si pikat kryesore të mbështetjes për kolegët e tyre;

**Objektivi strategjik 3:**

**Promovimi, mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin mendor të popullatës gjatë gjithë ciklit të jetës.**

**Objektivi specifik 3.1: Shtimi i ndërhyrjeve ndërgjegjësuere për shëndetin mendor me qëllim adresimin e stigmës, përjashtimit social dhe diskriminimit, me një qasje të ndjeshme ndaj grupeve specifike (fëmijë, adoleshentët, të rinjtë, gratë, të moshuarit dhe profesionistët shëndetësorë)**

**Treguesit:**

- Një plan aktiviteteve në nivel kombëtar për ditën e shëndetit mendor sipas temës dhe materialeve promovuese të shpërndara nga Koalicionit Pan-Evropian për Shëndetin Mendor;
- 70% e shkollave në zonat urbane dhe 60% e shkollave në zonat rurale janë përfshirë në programe që promovojnë shëndetin mendor pozitiv dhe trajtojnë sjelljet e rrezikshme si abuzimi me substancat, dhuna dhe bullizmi;
- Një program kundër stigmës ndaj shëndetit mendor, me angazhimin e adoleshentëve dhe të të rinjve, organizatave rinore, mbështetur në ndërhyrje të bazuara në prova, (programi mes kolegëve), i zbatuar;
- Manuali "Shëndeti Mendor: Të Sfidojmë Stigmën" i hartuar nga vetë të rinjtë, si një material i cili jep njohuri mbi aspekte të ndryshme të shëndetit mendor, të të kuptuarit më mirë të faktorëve shoqërorë të cilët krijojnë stigmatizim dhe mungesë ndërgjegjësimi, si një udhëzues për të adresuar sfida personale të shëndetit mendor, për të kërkuar ndihmë profesionale dhe për të menaxhuar problemin e stigmës dhe si një model i punës me të rinjtë dhe pikënisje për advokim për shëndetin mendor;
- Konferencë më të rinjtë "Përmirësimi i shërbimeve të shëndetit mendor të të rinjve dhe sfidimi i stigmës", e organizuar;
- 36 takime informuese në nivel vendor nga NJVKSH-të me të rinjtë mbi Shëndetin mendor të të rinjve dhe sfidimi i stigmës dhe njohja me Manualin e hartuar për këtë qëllim;
- Një fushatë kombëtare për shëndetin mendor të të rinjve e realizuar;
- Të paktën një takim informues në vit për çdo qark, në ambjentet më të frekuentuara nga të moshuarit (në kuadër të ditës së të moshuarve) për shëndetin mendor të të moshuarve, organizuar nga NJVKSH-të në bashkëpunim me aktorët lokalë;
- Takime lokale pranë NJVV-ve dhe NJVKSH-ve me përfaqësues nga përdoruesit e shërbimeve të shëndetit mendor, kujdestarët apo familjarët e tyre për nevojat socio-shëndetësore të tyre, të organizuara;
- % e popullatës përdor komponentët e shëndetit mendor të paketës së Kontrollit Shëndetësor Bazë 35-70 vjeç;
- Të paktën një website i ngritur me fokus prindërimin pozitiv dhe shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve;
- Hartimi i materialeve promovuese dhe informuese mbi çështje të ndryshme të shëndetit mendor, mënyrat si mund të arrihet dhe të ruhet mirëqenia në shëndet mendor, si mund të menaxhohen shqetësimet, lodhja, depresioni dhe ankthi;
- Materiale promovuese dhe zbatuese për informimin e publikut mbi vetëndihmën, të hartuara, me tema të tilla si: aktiviteti fizik, higjiena e gjumit, teknikat e relaksimit, vetëndihma, etj.;

- Kurrikulat e shkollave dhe programeve jashtëshkollore për çështjet e promovimit të shëndetit mendor, të zhvilluara;
- Takime vjetore në shkollave prindër dhe fëmijë për informimin e shërbimeve socio-shëndetësore të shëndetit mendor të ofruara në KSHP për identifikimin e hershëm, referimin në kohë dhe ndjekjen e vazhdueshme të problematikave të shëndetit mendor dhe sfidimin e stigmës;
- Aktivitetet që mbështesin sjelljet e shëndetshme zhvillohen në shkolla;
- Trajnimi i stafeve të promocionit shëndetësor në nivel qendror dhe vendor në fushën e shëndetit mendor me fokus të veçantë në ndërhyrjet në shkolla;
- Të paktën 4 (katër) takime vjetore të realizuara mes aktorëve të përfshirë në koordinimin efektiv në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor në shkolla, të realizuara;
- Studimi HBSC i realizuar periodikisht;
- Stafi i përfshirë në kërkimet shkencore i trajnuar, veçanërisht për studimet mbi shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve;
- Raporti për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale për fëmijët dhe adoleshentët, i hartuar mbi gjetjet e Studimit HBSC në Shqipëri;
- Numri i takimeve periodike informuese dhe mbështetëse të realizuara me profesionistë të ndryshëm të sistemit shëndetësor, mbi problemet e shëndetit mendor.

#### Masat:

- 3.1.1 Organizimi i aktiviteteve promovuese të përvitshme, nën sloganin e Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, nën koordinimin e OBSH-së për Evropën;
- 3.1.2 Organizimi i ndërhyrjeve promovuese në shkolla lidhur me shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve;
- 3.1.3 Zbatimi i mjeteve për angazhimin aktiv të adoleshentëve dhe të rinjve në diskutimet për shëndetin mendor, nëpërmjet edukimit të bashkëmoshatarëve dhe kanaleve të tjera të komunikimit në komunitet, duke përdorur "HAT toolkit" (Helping adolescents thrive) të UNICEF-it dhe OBSH-së;
- 3.1.4 Zhvillimi i njohurive të adoleshentëve dhe të rinjve mbi aspekte të ndryshme të shëndetit mendor, mënyrat e adresimit të sfidave personale të shëndetit mendor dhe modeleve të advokimit;
- 3.1.5 Fuqizimi i angazhimit dhe dialogut me të rinjtë mbi çështjet e shëndetit mendor me fokus të veçantë stigmën dhe diskriminimin si dhe i bashkëpunimit me institucionet publike në bashkëhartimin e politikave për mirëqenien dhe shëndetin mendor;
- 3.1.6 Rritja e ndërgjegjësimit të adoleshentëve dhe të rinjve mbi shëndetin e tyre mendor në nivel kombëtar nëpërmjet ndërhyrjeve kundër stigmës dhe diskriminimit, me anë të përcjelljes së mesazheve të bazuara në histori suksesi dhe modele pozitive;
- 3.1.7 Informim mbi shëndetin mendor të moshës së tretë, sfidat dhe menyrat e menaxhimit të tyre dhe kërkimi i ndihmës profesionale;
- 3.1.8 Informimi i popullatës mbi të mirat e depistimit për shenja të depresionit, pjesë e Programit i Kontrollit Shëndetësor Bazë 35-70 vjeç, me qëllim reduktimin e stigmës që ka çuar në përdorimin më të ulët të këtij komponenti brenda këtij programi parandalues dhe inkurajimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor në përdorimin e këtij programi për sëmundjet fizike bashkëshoqëruese;
- 3.1.9 Zhvillimi i aftësive advokuese mes përdoruesve të shërbimeve të shëndetit mendor, kujdestarëve apo familjarëve të tyre;
- 3.1.10 Promovimi i kujdesit dhe shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët (prindërimi pozitiv dhe vetëkujdesi), edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjisë, informacionit bazuar në prova (paketa INSPIRE e OBS-së), me fokus fëmijët dhe adoleshentët si grup-mosha më e prekshme prej keqinformimit;

- 3.1.11 Promovimi dhe informimi mbi çështje të ndryshme të shëndetit mendor, mënyrat si mund të arrihet dhe të ruhet mirëqenia e shëndetit mendor dhe si mund të menaxhohen shqetësimet e lidhura me shëndetin mendor;
- 3.1.12 Informimi i publikut mbi aspektet e vetëndihmës, duke përfshirë tema të tilla si: aktiviteti fizik, higjiena e gjumit, teknikat e relaksimit, vetëndihma, etj.;
- 3.1.13 Rishikimi i cilësisë së kurrikulës së shkollave dhe zhvillimi i programeve jashtëshkollore për çështjet e promovimit të shëndetit mendor, përfshirë përshtatjen me situata të ndryshme, sjelljet jo të shëndetshme, të tilla si abuzimi me substancat, dhuna dhe bullizimi;
- 3.1.14 Fushatë komunikimi për një shërbim parësor sa më miqësor për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë;
- 3.1.15 Krijimi i ambjenteve mbështetëse për promovimin e shëndetit pozitiv në shkolla;
- 3.1.16 Forcimi i kapaciteteve të specialistëve të promocionit shëndetësor në nivel vendor në fushën e shëndetit mendor me fokus të veçantë në ndërhyrjet në shkolla;
- 3.1.17 Fuqizimi i marrëdhënieve mësues-prindër-staf psikosocial të shkollës dhe specialistë të shërbimeve të shëndetit mendor, me qëllim koordinimin efektiv mes aktorëve kryesorë në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor në shkolla;
- 3.1.18 Kryerja e studimeve periodike dhe kërkimeve shkencore për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve, si HBSC, ACE, etj.;
- 3.1.19 Rishikimi, analiza e të dhënave parësore dhe kryerja e analizës dytësore të Studimit HBSC në Shqipëri 2021-2022 për të prodhuar një raport për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale për fëmijët dhe adoleshentët me gjetje dhe rekomandime në këtë fushë, si dhe trajnim i personave të përfshirë në zbatimin e kërkimeve shkencore;
- 3.1.20 Rritja e ndërgjegjësimit të profesionistëve shëndetësorë mbi rëndësinë e shëndetit mendor.

#### Objektivi Specifik 3.2: Zhvillim i ndërhyrjeve të promovimit të shëndetit mendor pozitiv dhe mirëqenies në vendin e punës si një nga përcaktuesit vendimtar të shëndetit të përgjithshëm të individit

#### Treguesit:

- Programe që pomovojnë shëndetin mendor pozitiv në vendin e punës të zhvilluara;
- Të gjitha institucionet shëndetësore kanë caktuar personin e kontaktit për zbatimin e programeve që mbrojnë shëndetin në vendin e punës;
- 2 workshope edukative për mirëqenien e shëndetit mendor në vendin e punës të organizuara;
- Trajnime të stafeve shëndetësore mbi mbështetjen mes kolegesh dhe menaxhimin e stresit në vendin e punës;
- Një fushatë ndërgjegjësimi për shëndetin mendor në vendin e punës, me fokus të veçantë profesionistët e shëndetësisë;
- 50 trajnerë të formuar për trajnimin e stafeve në shkolla për qëndrueshmëri dhe aftësi ripërtëritëse të shëndetit mendor.

#### Masat:

- 3.2.1 Zhvillimi i programeve që promovojnë shëndetin mendor pozitiv në vendin e punës, me fokus të veçantë institucionet shëndetësore dhe shkollat, në zbatim të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë;
- 3.2.2 Formalizimi i rrjetit të kontakteve pranë institucioneve kryesore shëndetësore për zbatimin e programeve që promovojnë shëndetin mendor pozitiv në vendin e punës;



- 3.2.3. Promovimi i mirëqenies së shëndetit mendor në vendin e punës dhe informimi lidhur me problemet e shëndetit mendor dhe fizik, të plotësuara edhe me informacion mbi burimet e mbështetjes, të profesionistëve jo-shëndetësorë në rrezik të lartë për përkeqësimin e shëndetit mendor për shkak të profesionit (sektori i teknologjisë dhe informacionit dhe ndërtimit si sektorët me rrezik më të lartë);
- 3.2.4. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve shëndetësorë mbi mbështetjen mes kolegësh, si dhe menaxhimin e stresit në vendin e punës dhe promovimin e shëndetit mendor pozitiv;
- 3.2.5. Ndërgjegjësimi i palëve të interesuara për promovimin dhe mbështetjen e shëndetit mendor në vendin e punës;
- 3.2.6. Rritja e kapaciteteve të stafeve psikosociale në shkolla për zbatimin e ndërhyrjeve për qëndrueshmëri dhe aftësi ripërtëritëse të shëndetit mendor të stafit të shkolla.

**Objektivi specifik 3.3: Zhvillimi i Programit Kombëtar për Parandalimin e Vetëvrasjeve, me fokus të veçantë adoleshentët dhe të rinjtë dhe i ndërhyrjeve të tjera parandaluese në grupet me rrezik të lartë.**

#### Treguesit:

- Vlerësimi i realizuar për situatën aktuale të vetëvrasjeve;
- Miratimi i planit të ndërhyrjeve për parandalimin e vetëvrasjeve;
- Programi i dedikuar për parandalimin e vetëvrasjeve të të burgosurve, i zhvilluar;
- Trajnime të stafeve zbatuese të programit për parandalimin e vetëvrasjeve të të burgosurve, të realizuara;
- Numri i takimeve informuese në shkolla, të zhvilluara;
- Një trajnim me gazetarë mbi raportimin e duhur të vetëvrasjeve;
- 100% e stafeve psikosociale në KSHP të aftë të ofrojnë mbështetje psikosociale, të bazuar në prova, për reduktimin e rrezikut të dëmtimit të vetes dhe rreziqeve të tjera të sjelljeve mes adoleshentëve dhe të rinjëve, kryesisht.

#### Masat:

- 3.3.1 Njohja e situatës aktuale të vetëvrasjeve, rastet në 10 vitet e fundit, shkaqet dhe grup-moshat, etj. me qëllim hartimin e ndërhyrjeve të informuara;
- 3.3.2 Hartimi i planit të ndërhyrjeve për zbatimin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Vetëvrasjeve;
- 3.3.3 Zhvillimi i një programi për parandalimin e vetëvrasjeve të të burgosurve dhe rritja e kapaciteteve zbatuese;
- 3.3.4 Informimi mbi rëndësinë e të folurit për vetëvrasjen, veçanërisht mes adoleshentëve dhe të rinjëve dhe kërkimi i ndihmës;
- 3.3.5 Fuqizimi i raportimit mediatik të përgjegjshëm të gazetarëve mbi vetëvrasjet duke synuar njohjen e ndikimit të mënyrës së raportimit të lajmeve mbi këtë fenomen dhe se si kjo fuqi (raportimi mediatik) mund të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit publik të popullatës nëpërmjet raportimit mediatik të përgjegjshëm;
- 3.3.6 Zhvillimi i kapaciteteve të stafit psikosocial në KSHP për ofrimin e mbështetjes psikosociale, të bazuar në prova, për reduktimin e rrezikut të dëmtimit të vetes dhe rreziqeve të tjera të sjelljes mes adoleshentëve dhe të rinjëve, kryesisht.

## Objektivi strategjik 4:

Zhvillim i mëtejshëm i kuadrit rregullator dhe praktikës të lidhur me shëndetin mendor, në dritën e të drejtave të njeriut dhe mekanizmave monitoruese dhe qeverisëse të shërbimeve të shëndetit mendor

**Objektivi specifik 4.1: Zhvillimi i paketës rregullatore për shëndetin mendor në dritën e të drejtave të njeriut**

#### Treguesit:

- Aktet nënligjore të rishikuara në përputhje me kuadrin e ri rregullator të shëndetit mendor të OBSH-së;
- Kuadri rregullator në shëndet mendor, i përditësuar;
- Standardet e shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor, të miratuara;
- Të paktën 3 shërbime të specializuara të shëndetit mendor, të akredituara sipas standardeve;
- VKM për rregullat e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve mjekësore të posaçme, e miratuar;
- Rregullorja e shëndetit mendor, e përditësuar;
- Paketa e shërbimit socio-shëndetësor në banesë, e miratuar.

#### Masat:

- 4.1.1 Rishikimi i akteve përkatëse nënligjore, në përputhje me udhëzuesin e ri për legjislacionin e shëndetit mendor të OBSH-së, standardet e KDPAK si dhe Acquis të BE për shëndetin mendor;
- 4.1.2 Përditësimi i kuadrit rregullator që mundëson dhe përmirëson ofrimin dhe qasjen në shërbime të integruara ndërsektoriale për fëmijët dhe adoleshentët në nevojë për mbështetje psikosociale dhe në shëndet mendor;
- 4.1.3 Hartimi i standardeve të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor dhe nisja e procesit të akreditimit;
- 4.1.4 Hartimi i rregullave për ngritjen dhe funksionimin e Institucioneve Mjekësore të Posaçme, në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të autoriteteve monitoruese kombëtare (AP, KMD, etj.) dhe ndërkombëtare (CPT) në këtë fushë;
- 4.1.5 Harmonizimi i funksionimit të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor, në koordinim me funksionet e reja të shërbimeve të KSHP-së dhe rolet dhe përgjegjësitë e stafeve psikosociale pranë KSHP-së;
- 4.1.6 Zhvillimi i shërbimit socio-shëndetësor në banesë për personat e moshës së tretë, me fokus edhe problemet e shëndetit mendor në këtë grup-moshë.

**Objektivi specifik 4.2: Zhvillimi i paketës së praktikës së stafeve multidisiplinare të shërbimeve të shëndetit mendor**

#### Treguesit:

- Miratimi i roleve dhe përgjegjësisë të sektorit të shëndetit mendor;
- Përditësimi i roleve dhe përgjegjësisë të secilit profil profesional, pjesë e ekipeve multidisiplinare të shëndetit mendor;



- 4 (katër) takime rajonale (në nivel DROSHKSH) të organizuara për njohjen e roleve të reja të profesionistëve të shërbimeve të shëndetit mendor
- 100% e stafeve psikosociale të QKSHM-ve përdorin instrumente vlerësuese të unifikuara;
- Miratimi i udhëzuesit të praktikës për logopedët dhe fizioterapeutët e qendrave socio-shëndetësore dhe të rehabilitimit, sipas kategorive të shërbimeve.
- Hartimi i udhërrëfyesit për ofrimin e kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.

#### Masat:

- 4.2.1 Përditësimi i roleve të profesionistëve të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor, në kuadër të zhvillimit të shërbimit psikosocial dhe të shërbimit në banesë në KSHP;
- 4.2.2 Ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve të shëndetit mendor në dritën e respektimit të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor;
- 4.2.3 Informimi i stafeve të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor mbi përditësimin e kuadrit rregullator në fuqi në këtë fushë me qëllim lehtësimin e zbatueshmërisë së tij;
- 4.2.4 Përmirësimi i cilësisë së shërbimit psikosocial pranë QKSHM-ve;
- 4.2.5 Përmirësimi i cilësisë së shërbimit rehabilitues në qendrat socio-shëndetësore dhe të rehabilitimit sipas kategorive të shërbimeve;
- 4.2.6 Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit të ofruar për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore në përgjigje të rekomandimeve të CPT-së.

#### Objektivi specifik 4.3: Përmirësimi i mekanizmave monitoruese, qeverisëse dhe të advokimit në shëndet mendor

#### Treguesit:

- VKM nr. 456, datë 22.05.2013 "Për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Shëndetit Mendor" i ndryshuar;
- Ngritja e nënkomitetit për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe të adoleshentëve dhe organizimi i të paktën dy takime në vit të KKSMM-së;
- Realizimi i takimeve periodike të nënkomitetit për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe të adoleshentëve;
- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes MSHMS-së dhe MAS-it për zbatimin e ndërhyrjeve promovuese në shkollë në lidhje me shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe të stafeve multidisiplinare të shkollave;
- Plani i përbashkët i veprimit mes MSHMS-së dhe MD-së për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore "mjekim i detyruar", i rishikuar;
- Takimet periodike të grupit të punës për monitorimin e zbatimit të planit të përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të realizuara;
- Studimi krahasues mbi trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore "mjekim i detyruar", duke përfshirë politikën e liritimit/daljes nga institucioni i këtyre pacientëve, i realizuar;
- Transferimi i burimeve infrastrukturore, njerëzore dhe financiare të QKSHM-ve dhe shtëpive mbështetëse të qarqeve të Elbasanit dhe Vlorës drejt NJVKSH-ve përkatëse;
- Spitali Psikiatrik Elbasan, Spitali Psikiatrik Vlorë, Shërbimi i Shëndetit Mendor me Shtretër

Shkodër, Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë e Mbështetura financohen nga FSDKSH;

- Rolet dhe përgjegjësitë e sektorit të shëndetit mendor pranë NJVKSH-ve, të miratuara;
- Raporte vjetore të sektorëve të shëndetit mendor të NJVKSH-ve pranë secilës DROSHKSH, të përcjella pranë MSHMS-së;
- Numri i takimeve të Koalicionit Pan-Evropian të Shëndetit Mendor të OBSH-së, takimeve rajonale të këtij koalicioni dhe në rrjetin e Ballkanit Perëndimor me pjesëmarrjen e anëtarit përkatës të Shqipërisë;
- Numri i takimeve të Rrjetit Rajonal Për Shëndetin Mendor (SEEHN/RCMH);
- Numri i aktiviteteve për shkëmbim përvojash dhe njohurish, si dhe mbështetja teknike e ofruar për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve, të realizuara;
- Raporte vjetore inspektimi të shërbimeve të shëndetit mendor nga ISHSH, të përcjella në MSHMS;
- 4 plane rajonale në zbatim të këtij plani veprimi të hartuara, me pjesën e shëndetit mendor dhe mirëqenies psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve, të integruar;
- Plani për advokim të shëndetit mendor dhe mirëqenies psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve prezantuar nënkomitetit përkatës të KKSMM-së;
- Analiza e kuadrit ligjor dhe strategjik ndërsektorial për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve, i realizuar;
- Një grup treguesish për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve për shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve, i hartuar;
- Numri i profesionistëve të trajnuar për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve për shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve;
- Manuali për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për personat me çrregullime të shëndetit mendor, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, i hartuar;
- Një konferencë kombëtare për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve, e organizuar me pjesëmarrje të gjerë;
- Të paktën dy vizitave studimore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të organizuara;
- Dy raporte vlerësimi të zbatueshmërisë (afatmesëm dhe përfundimtar), të planit të veprimit për shëndetin mendor 2023-2026, të hartuara.

#### Masat:

- 4.3.1 Fuqizimi i Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor (zgjerimi i anëtarësisë dhe kompetencave) me qëllim zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse të qeverisjes së shëndetit mendor, nëpërmjet zgjerimit të pjesëmarrjes me përfaqësues të ministrive të linjës, institucioneve shëndetësore dhe sociale në nivel qendror, të qeverisjes vendore, të agjencive të pavarura dhe aktorëve të shoqërisë civile;
- 4.3.2 Fuqizimi i lidershipit, qeverisjes dhe advokimit për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe të adoleshentëve;
- 4.3.3 Formalizimi i bashkëpunimit ndërsektorial në nivelin më të lartë mes MSHMS-së dhe MAS-it për zbatimin e ndërhyrjeve promovuese në shkollë lidhur me shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe të stafeve multidisiplinare të shkollave (marrëveshje bashkëpunimi);
- 4.3.4 Rishikimi i aktiviteteve të planit të përbashkët të veprimit mes MSHMS-së dhe MD-së, shtojca e marrëveshjes së bashkëpunimit, për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore "mjekim i detyruar", me qëllim reflektimin e zhvillimeve dhe trajtimin e pengesave të identifikuar në zbatim;
- 4.3.5 Sigurimi i funksionimit të vazhdueshëm të grupit të punës për monitorimin e zbatimit të planit të përbashkët të veprimit mes MSHMS-së dhe MD-së, për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore "mjekim i detyruar";

- 4.3.6 Njohja e praktikave të ndryshme ndërkombëtare për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore "mjekim i detyruar" nëpërmjet realizimit të një studimi krahasues, duke përfshirë politikat e liritimit/daljes nga institucioni të këtyre pacientëve;
- 4.3.7 Standardizimi i varësisë institucionale të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor, nga varësia prej shërbimit të shëndetit mendor me shtretër drejt NJVKSH-ve, me qëllim fuqizimin dhe përmirësimin e funksionit të tyre komunitar;
- 4.3.8 Riorganizimi dhe financimi i shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor, nga i vetmi blerës i shërbimit shëndetësor, FSDKSH; në bazë të ligjit Ligji nr. 10107, datë 30.03.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Ligjit Nr.44/2012 "Për shëndetin mendor", i ndryshuar;
- 4.3.9 Hartimi i roleve dhe përgjegjësi të sektorit të shëndetit mendor pranë NJVKSH-ve, kryesisht në koordinim, monitorim dhe promovim të shëndetit mendor të popullatës sipas zonës së mbulimit;
- 4.3.10 Fuqizimi i rolit të sektorit që mbulon shëndetin mendor në MSHMS nëpërmjet angazhimit në mekanizmat evropiane dhe rajonale për shëndetin mendor; të OBSH-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;
- 4.3.11 Rritja e ekspertizës në drejtim të qeverisjes së shëndetit mendor, me fokus të veçantë shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, nëpërmjet mbështetjes ndërkombëtare dhe shkëmbimit të njohurive dhe përvojave më të mira;
- 4.3.12 Fuqizimi i rolit inspektues të ISHSH-së për shërbimet e shëndetit mendor;
- 4.3.13 Fuqizimi i rolit të aktorëve lokalë të qeverisjes dhe advokimit për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe të adoleshentëve, nëpërmjet hartimit të 4 (katër) planeve rajonale (sipas ndarjes së OSHKSH);
- 4.3.14 Zhvillimi i advokimit për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve me përfshirjen e shoqërisë civile;
- 4.3.15 Vlerësimi i kuadrit strategjik dhe ligjor ndërsektorial (shëndetësor, social, mbrojtja e fëmijëve, arsimit, etj.) për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve me qëllim informimin e vendimmarrjes përkatëse;
- 4.3.16 Zhvillimi i një kuadri monitorimi për kujdesin ndërsektorial të integruar për fëmijët dhe adoleshentët që kanë nevojë për mbështetje për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale;
- 4.3.17 Ngritja e kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin e kuadrit monitorues për kujdesin ndërsektorial të integruar për fëmijët dhe adoleshentët që kanë nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor;
- 4.3.18 Rritja e qasjes së personave me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimet e ndihmës juridike falas, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi;
- 4.3.19 Mbështetja e konsultimeve të gjera për ndarjen e ideve, të përvojave, sfidave dhe planeve për të ardhmen, mes palëve të interesuara në shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve;
- 4.3.20 Shkëmbimi i përvojave me vendet me sisteme të përparuara të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore;
- 4.3.21 Vlerësimi i vazhdueshëm i zbatueshmërisë së këtij plani veprimi me qëllim identifikimin në kohë të barrierave në zbatim dhe adresimin e tyre.

# MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR SHËNDETIN MENDOR 2023-2026

Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026 do të monitorohet me anë të treguesve të secilës masë, të cilët do të kategorizohen sipas gjinisë dhe grup-moshave aty ku është e mundur.

Të dhënat do të mblidhen nga institucionet kombëtare përgjegjëse për aktivitete të veçanta, raportet kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësimet e standardizuara, studimet e politikave dhe programeve dhe burime të tjera.

Plani i Veprimit është planifikuar t'i nënshtrohet një rishikimi afatmesëm në vitin 2024, i cili do t'i prezantohet KKSHM-së dhe më pas Ministrit të Shëndetësisë dhe një raport përfundimtar do të përgatitet për Organet Drejtuese në vitin 2026.

## Përshkrimi i Buxhetit dhe Matrica e Planit të Veprimit

### Kostot e vlerësuara dhe burimet e financimit

Metodologjia e përdorur për vlerësimin e kostos së Planit të Veprimit të Shëndetit Mendor bazohet në metodën e kostimit në bazë të masave, konkretisht të aktiviteteve. Kjo metodë vlerëson kostot si një proces i përbërë nga dy faza: a) nga burimet tek aktivitetet; dhe b) nga aktivitetet tek kostoja e objektivave.

Kostot e vlerësuara për secilin aktivitet janë përlogaritur në bazë të tri kategorive kryesore të shpenzimeve buxhetore: Kostot e shpenzimeve korente (602); Burimet Njerëzore (600+601) dhe Investimet (201).

Ndërmjet vlerësimit të koston është bërë i mundur edhe identifikimi i burimeve të ndryshme të financimit, që është një element vendimtar për ushtrimin e kostimit, të cilat janë:

- Së pari, kontributi i fondeve publike nëpërmjet buxhetit të shtetit, me anë të Programit të Buxhetit Afatmesëm (PBA) 2023-2025, alokimeve të miratuara dhe të vlerësuara për ministrinë përkatëse dhe programeve buxhetore;
- Së dyti, kontributi i donatorëve potencialë që do të mund të kontribuojnë në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të këtij plani veprimi.

Vlerësimi i burimeve kryesore krahasuar me koston e vlerësuar të aktiviteteve bën të mundur identifikimin e hendekut financiar (GAP) për sa u përket shumave dhe burimeve të financimit për secilën masë, për secilin objektiv, si dhe hendekun e përgjithshëm në financimin e këtij Planit Veprimi.

Kostot e vlerësuara të përfshira në Planin e Veprimit do të rishikohen të paktën çdo dy vjet, për të identifikuar se deri në çfarë mase do të jetë i mundur mobilizimi i alokimeve shtesë nga Buxheti i Shtetit për politikat e Planit të Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026, si dhe i kontributeve të donatorëve në të ardhmen.


Është vlerësuar se kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit do të jetë 3,500,774,000 Lekë, për periudhën 2023-2026.

Përlllogaritjet e buxhetit, siç kërkohen nga prioriteti strategjik, paraqiten në tabelën e mëposhtme.


Në paraqitjen grafike jepen detajet në lidhje me përqindjen e fondeve buxhetore kundrejt donatorëve, ndarjet totale të buxhetit sipas 4 objektivave.

Në ndarjet e burimeve të financimit shohim që peshën më të madhe e zë PBA, krahasimisht me donatorët, për arsye se edhe rëndesën më të madhe e kanë investimet dhe fondi i pagave për stafin shëndetësor të planifikuar (referojuni tabelës 1 dhe 2). Nga ana tjetër, nëse vërejmë peshën e secilit objektiv në buxhetin total të planit të veprimit është Objektiv 1 ku përfshihen ndërhyrjet me kosto më të lartë si masa të planit të veprimit (p.sh. investime me ndërtime të reja të shtëpive, rikonstruksione të spitaleve dhe qendrave etj.) dhe punësimi i një numri të madh personeli shëndetësor (fondi vjetor i pagave) në kuadër të zbatimit të këtij plani. Si rrjedhojë, këto kosto rëndojnë kryesisht zërin e financimit nga PBA, ndërsa hartimi i dokumenteve të ndryshme, rritja e kapaciteteve dhe ndërhyrjet promovionale në mbështetje të masave të planit të veprimit që dominojnë në objektivat 2, 3 dhe 4 financohen një pjesë nga PBA dhe pjesa tjetër nga donatorët. Në këtë plan vërejmë edhe hendekun e krijuar nga diferenca e ketyre dy zërave të mësipërm që konsiston kryesisht në asistencë teknike dhe organizime aktiviteteve, pjesë e kostove operative.


**Figura 1. Buxheti total sipas Burimeve të Financimit në %**




**Figura 2. Buxheti total sipas Burimeve të Financimit në vlerë në Lekë (/1000)**



**Figura 3. Buxheti i ndarë për secilin objektiv në %**



**Figura 4. Buxheti i ndarë për secilin objektiv në vlerë në Lekë (/1000)**



# Matrica e Buxhetit dhe Planit të Veprimit për Shëndetin Mendor 2023 - 2026

Masat	Institucionet/ Agjencitë zbatuese	Treguesit	Vitet e zbatimit	Kosto e Aktivitetit (000/ Lekë)				PBA (000/ ALL)			Donatorët (000/ Lekë)	GAP (000/ Lekë)		
				Burime Njerëzore (600+601)	Kosto Korente (602)	Investimet (231)	Total	Burim Njerëzore (600+601)	Kosto Korente (602)	Investimet (231)			Total	
<b>Objektivi specifik 1: Zhvillimi i shërbimeve të shëndetit mendor me fokus mbulimin shëndetësor universal</b>					2,345,631	49,168	968,793	3,363,592	2,344,081	34,109	960,972	3,339,162	12,210	12,220
<b>Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i shërbimeve të shëndetit mendor në KSHP</b>														
1	Zhvillimi i paketës për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP me qëllim fuqizimin e integritetit të shëndetit mendor në këtë nivel shërbimesh;	<b>MSHMS, HAP, ASCK, OSHKSH/ NJVKSH</b>	Udhërrëfyësi për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP i miratuar.	2023	224	-	-	224	224	-	-	224	-	-

2	Fuqizimi i kapaciteteve të mjekëve të përgjithshëm dhe infermierëve për identifikimin, trajtimin, referimin në kohë dhe ndjekjen e vazhdueshme të problemeve të shëndetit mendor, në nivel kombëtar, sipas paketës së zhvilluar për këtë qëllim dhe nëpërmjet trajnimeve kaskadë, të akredituara;	<b>MSHMS, HAP, ASCK, OSHKSH/ NJVKSH</b>	6 trajnerët e parë të trajnuar për trajnim trajnerësh për zbatimin e udhërrëfyësit	2023	90	-	-	90	90	-	-	90	-	-
			Programi i trajnimit i akredituar; 100% e mjekëve të përgjithshëm, mjekëve të familjes dhe infermierëve të mjekësisë së familjes të trajnuar për zbatimin e udhërrëfyësit të ri për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP; 2 trajnime me mjekët e përgjithshëm për diagnostikimin dhe memanaxhimin e depresionit dhe ankthit	2023-2026	420	-	-	420	120	-	-	120	180	120
3	Rifreskimi i i vazhdueshëm i njohurive dhe kapaciteteve të personelit të kujdesit shëndetësor parësor në menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP;	<b>MSHMS, OSHKSH/ NJVKSH</b>	Një trajnim dy-ditor i organizuar	2026	20	-	-	20	20	-	-	20	-	-
4	Fuqizimi i kapaciteteve të stafëve që ofrojnë shërbimin shëndetësor në banesë, edhe për të moshuarit, me fokus shëndetin e tyre mendor;	<b>MSHMS, HAP, ASCK, OSHKSH/ NJVKSH</b>	Të paktën 100 infermierë të aftësuar për ofrimin e shërbimit në banesë, për të moshuarit, me fokus edhe problemet e shëndetit mendor;	2024-2026	1,155	120	-	1,275	1,155	120	-	1,275	-	-

5	Informimi mbi problematikat e shëndetit mendor për grupet e cenushme, me fokus të veçantë të moshuarit, pjesë e shërbimit në banesë në KSHP, në të gjitha qarqet ku janë ngritur dhe funksionojnë shërbimet e specializuara të shëndetit mendor;	<b>MSHMS, OSHKSH/ NJVKSH, NJVV</b>	Të paktën 6 takime në 6 qarqet ku janë ngritur dhe funksionojnë QKKSHM-te, të organizuara;	<b>2024-2026</b>	<b>139</b>	-	-	<b>139</b>	<b>139</b>	-	-	<b>139</b>	-	-
6	Shtrirja dhe fuqizimi i shërbimit psikosocial në KSHP dhe përmirësimi i ndërveprimit me shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor;	<b>MSHMS, OSHKSH/ NJVKSH</b>	100 profesionistë psikosocialë të atashuar pranë QSH-ve brenda vitit 2023; 100% e QSH-ve të pajisura me staf psikosocial; Të paktën 12 takime lokale mes ofruesve të shërbimeve të shëndetit mendor të parësorit dhe të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor me bazë komunitare si dhe përfaqësues të qeverisjes vendore - të organizuara.	<b>2023-2026; 2023-2024</b>	<b>280</b>	-	-	<b>280</b>	<b>280</b>	-	-	<b>280</b>	-	-

**Objektivi specifik 1.2: Fuqizimi i shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë**

1	Përmirësimi i punës së Konsultorit të Fëmijës, në KSHP, në lidhje me identifikimin, referimin dhe ndjekjen e probematikave të shëndetit mendor, veçanërisht për grup-moshën 0-6 veç, në zbatim të protokolleve të përditësuara;	<b>MSHMS, OSHKSH</b>	100 % e mjekëve të Konsultorit të Fëmijës të trajnuar për zbatimin e protokolleve të përditësuara në shëndet mendor; 100% e infermierëve të Konsultorit të Fëmijës të trajnuar për zbatimin e protokolleve të përditësuara në shëndet mendor	<b>2023-2026</b>	<b>447</b>	-	<b>40</b>	<b>487</b>	<b>447</b>	-	<b>40</b>	<b>487</b>	-	-
2	Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve ekzistuese të shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët, të ofruara nga QKSHM-të, përfshirë aftësitë për të identifikuar, trajtuar dhe referuar raste me probleme të shëndetit mendor, si problemet e zhvillimit dhe të sjelljes në fëmijët dhe adoleshentët, si dhe rastet me mendime për vetëdëmtim mes adoleshentëve.	<b>MSHM/ OSHKSH</b>	Të paktën 4 ekipe të reja multidisiplinare për fëmijët dhe adoleshentët, shtohen dhe funksionojnë pranë QKSHM-ve të ngritura në nivel qarku (Tiranë; Korçë, Vlorë dhe Berat);	<b>2024-2026</b>	<b>1,152</b>	-	-	<b>1,152</b>	<b>1,152</b>	-	-	<b>1,152</b>	-	-



3	Zbatimi i seanceve për shkëmbimin e eksperiencës mes ekipeve të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor;	<b>MSHMS, OSHKSH</b>	5 ditë trajnim i 4 ekipeve të reja për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve të trajnuar pranë QKSHM-ve që e ofrojnë këtë shërbim;	<b>2024-2026</b>	<b>916</b>	-	-	<b>916</b>	<b>916</b>	-	-	<b>916</b>	-	-
4	Rifreskimi i njohurive të stafeve shëndetësore të Konsultorit të Fëmijës në KSHP, në lidhje me identifikimin, referimin dhe ndjekjen e problematikave të shëndetit mendor, veçanërisht për grup-moshën 0-6 vjeç, në zbatim të protokolleve të përditësuara, pjesë e paketës së edukimit të detyrueshëm shëndetësor;	<b>MSHMS</b>	Të paktën një trajnim i organizuar për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP;	<b>2026</b>	<b>109</b>	-	-	<b>109</b>	<b>109</b>	-	-	<b>109</b>	-	-
5	Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në KSHP për ofrimin shërbimeve të shëndetit mendor dhe mirëqenien psikosociale për gratë pas lindjes (post-partum) me probleme të shëndetit mendor, duke pasur në konsideratë edhe statusin e tyre si kujdestare të fëmijëve të porsalindur;	<b>MSHM, UNICEF</b>	100% e stafeve shëndetësore të trajnuar, në një qark të caktuar, për kujdesin e grave pas lindjes (post-partum) që kanë nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor;	<b>2024</b>	<b>155</b>	-	<b>1,834</b>	<b>1,989</b>	<b>155</b>	-	-	<b>155</b>	<b>1,834</b>	-

6	Forcimi i sistemit të kujdesit për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor dhe mirëqenies e zhvillimit psikosocial të fëmijëve-adoleshentëve dhe familjeve të tyre, të integruara, të arritshme dhe miqësore në fëmijët, përfshirë shërbimet e specializuara të shëndetit mendor me bazë komunitare, kujdesin shëndetësor parësor, shërbimet psikosociale të arsimit parauniversitar, etj.;	<b>MSHMS, MAS, UNICEF, OSH</b>	Paketa e shërbimeve të shëndetit mendor, mirëqenies psikosociale dhe e zhvillimit për fëmijët dhe adoleshentët në KSHP e rishikuar; Paketa e shërbimeve të shëndetit mendor, mirëqenies psikosociale dhe e zhvillimit për fëmijët dhe adoleshentët në nivel QKSHM-sh e hartuar; Paketa e shërbimeve të shëndetit mendor, mirëqenies psikosociale dhe e zhvillimit për fëmijët dhe adoleshentët në nivel arsimit parauniversitar e rishikuar;	<b>2023</b>	<b>155</b>	-	<b>809</b>	<b>964</b>	<b>155</b>	-	-	<b>155</b>	<b>809</b>	-
7	Zhvillimi i rrugëve të integruara ndërsektoriale për identifikimin, trajtimin, kujdesin dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë për mbështetje psikosociale dhe në shëndet mendor, përfshirë udhëzues për rrugët e referimit, protokolle pune, rregullat e referimit, rolet dhe përgjegjësitë e secilit profesionist, kompetencat, etj.;	<b>MSHMS, MAS, OSH</b>	Udhëzues për rrugët e referimit i hartuar; Protokolle pune të hartuara; Rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat e secilit profesionist të hartuara;	<b>2023</b>	<b>77</b>	-	<b>432</b>	<b>509</b>	<b>77</b>	-	-	<b>77</b>	<b>432</b>	-

8	Shtirirja në nivel rajonal e modelit të shërbimit të ofruar nga QKTRF;	<b>MSHMS</b>	Studim fizibiliteti për ngritjen e Qendrave Rajonale Terapeutike dhe Rehabilituese të ngritura (në Elbasan ose Vlorë), sipas modelit të QKTRF-së;	<b>2025-2026</b>	132, 841	-	100, 000	232, 841	132, 841	-	100, 000	232, 841	-	-
9	Rritja e kapaciteteve të punonjësve shëndetësorë për t'u ofruar prindërve dhe kujdestarëve të tjerë mbështetje psikosociale dhe prindërim pozitiv	<b>MSHMS, DONATORËT</b>	Të paktën 10 trajnime të zhvilluara për stafet shëndetësore në ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe këshillave për prindërim pozitiv	<b>2025-2026</b>	1, 261	-	-	1, 261	1, 261	-	-	1, 261	-	-
10	Zhvillimi i një pakete trajnime për profesionistët që ofrojnë kujdes dhe trajtim për fëmijët dhe adoleshentët në nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor	<b>MSHMS; OBSH</b>	Paketa e trajnimit e zhvilluar	<b>2023</b>	-	-	324	324	-	-	-	-	324	-
11	Zhvillimi i kapaciteteve për kujdesin e fëmijëve dhe adoleshentëve që kanë nevojë për mbështetje psikosociale dhe në aspekte të shëndetit mendor, në një qark të identifikuar paraprakisht nga trajnimi i trajnerëve, mbikëqyrja e mbështetur, trajnimet nëpërmjet trajnerëve të formuar dhe ndjekja në vazhdim;	<b>MSHMS, OBSH, UNICEF</b>	1 seancë trajnim trajnerësh i organizuar; Trajnim kaskadë i realizuar; Mbikëqyrje e stafeve të aftësuar i ofruar	<b>2023</b>	232	-	1, 079	1, 311	232	-	-	232	1, 079	-

12	Përshtatja, testimi dhe përfundimi i një udhëzuesi për ofruesit jo-profesionistë dhe kujdestarët mbi strategjitë për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor të adoleshentëve dhe reduktimin e vetëdëmtimit dhe rreziqeve të tjera, bazuar në manualin e OBSH-së dhe UNICEF-it, "Helping adolescents thrive toolkit";	<b>MSHMS, MAS, OBSH</b>	Udhëzuesi për ofruesit jo-profesionistë dhe kujdestarët mbi strategjitë për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe reduktimin e vetëdëmtimit dhe rreziqeve të tjera, bazuar në manualin e OBSH-së dhe UNICEF-it, "Helping adolescents thrive toolkit" ("Të ndihmojnë adoleshentët të ecin përpara") i miratuar;	<b>2023</b>	77	-	540	617	77	-	-	77	540	-
13	Përshtatja dhe përdorimi në shkolla, si pjesë e programeve të promovimit të shëndetit mendor të "Teacher's Guide and Comic Book", pjesë e "Helping adolescents thrive toolkit", të OBSH-së dhe UNICEF-it, me qëllim lehtësimin e të kuptuarit dhe diskutimin e çështjeve të ndryshme të shëndetit mendor.	<b>MSHMS, MAS, UNICEF</b>	Udhëzuesi për mësuesit "Teacher's Guide and Comic Book" ("Udhëzues për mësuesin dhe libër vizatimor") pjesë e paketës "Helping adolescents thrive toolkit", të OBSH-së dhe UNICEF-it, i përshtatur dhe në përdorim në shkolla;	<b>2024</b>	91	-	-	91	91	-	-	91	-	-

**Objektivi specifik 1.3: Përsheptimi i procesit të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të shëndetit mendor duke zhvendosur me shpejtësi burimet drejt shërbimeve socio-shëndetësore komunitare të shëndetit mendor**

1	Sigurimi i vazhdimësisë dhe qendrueshmërisë së shërbimeve komunitare të shëndetit mendor;	MSHMS	10 QKSHM-të dhe 14 shtëpitë e mbështetura mbështeten financiarisht për funksionimin e tyre të plotë	2023-2026	1,178,585	-	-	1,178,585	1,178,585	-	-	1,178,585	-	-
2	Fuqizimi i autonomisë financiare të QKSHM-ve në lidhje me menaxhimin e të ardhurave dytësore nga vetë këto shërbime në funksion të përmirësimit të kushteve dhe ndërhyrjeve rehabilituese të ofruara nga vetë ato;	MSHMS	Grup pune për mënyrën e menaxhimit të të ardhurave dytësore të QKSHM-ve;	2025	155	-	-	155	155	-	-	155	-	-
3	Pasurimi i rrjetit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor (QKSHM), kryesisht në qarqet e mëdha të vendit;	MSHMS	Të paktën 4 QKSHM të ngritura dhe funksionale në qarqet më të mëdha të vendit;	2025-2026	531,362	-	200,000	731,362	531,362	-	200,000	731,362	-	-
4	Fuqizimi i kapaciteteve të stafëve të reja multidisiplinare mbi tipologjitë e shërbimeve komunitare të shëndetit mendor;	MSHMS	8 seanca trajnimi (5 ditore) të oraganizuara të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor ekzistuese, për aftësimin e stafëve multidisiplinare të shërbimeve të reja komunitare	2025-2026	208	-	-	208	208	-	-	208	-	-
5	Sigurimi i vazhdimësisë së ofrimit të shërbimeve me shtretër të shëndetit mendor;	MSHMS	Shërbimeve të shëndetit mendor me shtretër ju sigurohet mbështetje financiare për funksionim të plotë;	2023-2026	695	-	-	695	695	-	-	695	-	-

6	Rirorganizimi i shërbimit rezidencial (rezidentëve kronikë) të spitaleve psikiatrike në funksion të ofrimit të një shërbimi rehabilitues sa më dinjotoz dhe të individualizuar;	MSHMS	Ambientet e Spitalit Psikiatrik Vlorë ku akomodohen dhe trajtohen pacientët rezidentë kronikë, të rikonstruktura dhe të mobiluara; Projekti preventiv për rikonstrukcionin e Spitalit Psikiatrik Elbasan i zbatuar; Rikonstrukcioni dhe pajisjet e hotelerisë dhe industriale të Spitalit Psikiatrik Elbasan të realizuara;	2023-2025	-	-	240,000	240,000	-	-	240,000	240,000	-	-
7	Përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, në respekt të dinjitetit njerëzor sipë drejtave të njeriut;	MSHMS, BB	Rikonstrukcioni i Shërbimit Psikiatrik, pranë QSUT i zbatuar;	2023-2024	-	-	180,932	180,932	-	-	180,932	180,932	-	-
8	Mbështetja me shërbime rehabilituese të ofruara në formën e shtëpive mbështetëse për personat me çrregullime kronike të shëndetit mendor të referuar nga komuniteti;	MSHMS	Ngritja e të paktën 4 (katër) shtëpive të mbështetura për rehabilitimin e personave me çrregullime kronike të shëndetit mendor të referuar nga komuniteti;	2025-2026	83,373	-	240,000	323,373	83,373	-	240,000	323,373	-	-

9	Integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor me shtretër në shërbimet e përgjithshme shëndetësore, nëpërmjet pilotimit të shtretërve psikiatrikë/ pavioneve psikiatrike (akut/ subakut) pranë një spitali rajonal;	MSHMS	Projektfizibiliteti për ngritjen e një pavion psikiatrik/ shërbimi të shëndetit mendor më shtretër në një spital rajonal, i realizuar	2026	-	20,000	-	20,000	-	20,000	-	20,000	-	-
10	Përmirësimi i shërbimeve të trajtimit dhe rehabilitimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor më masë mjekësore, në përbushje të standardeve ndërkombëtare dhe rekomandimeve të autoriteteve monitoruese kombëtare (AP, KMD, etj.) dhe ndërkombëtare (CPT), dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;	MSHMS, SASPAC, MD, DPB	Projektpropozimi (Action Fiche) dhe Dokumenti i Veprimit (Action Document) për ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm për financim nga IPA, i hartuar, në përgjigje edhe të rekomandimeve të autoriteteve monitoruese kombëtare (AP, KMD, etj.) dhe ndërkombëtare (CPT);	2023	682	-	-	682	682	-	-	682	-	-
11	Fuqizimi i bashkëpunimit me strukturat e shërbimeve sociale në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me fokus shërbimet komunitare për personat me çrregullime të shëndetit mendor;	MSHMS	Të paktën 3 (tri) takime në vit, të ekipeve shëndetësore dhe strukturat e shërbimeve sociale të njësisë të vetëqeverisjes vendore, me fokus shërbimet komunitare për personat me çrregullime të shëndetit mendor, koordinuar nga sektorët e shëndetit mendor pranë NJVKSH-ve;	2023-2026	218	-	-	218	218	-	-	218	-	-

12	Pilotimi i shërbimit të mbështetjes për jetesë të pavarur dhe të vendimtarjes së mbështetur të personave me aftësi të kufizuara mendore dhe mbështetjes së duhur për kujdestarët/ asistentët personalë dhe familjarëve të personave me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor.	MSHMS, OSHKSH/ SANT'EGIDIO	2 (dy) apartamente të mbështetura (me kapacitet 3-4 persona/ secila) të ngritura dhe funksionale, pranë shtëpive mbështetëse të Kavajës dhe Tiranës, për përgatitjen për jetesë të pavarur të personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë përfituar nga shërbimi rehabilitues i shtëpive të mbështetura; 6-8 persona përfitojnë shërbime të jetesës së pavarur në apartamentet e mbështetura; 2 (dy) grupe teknike ndërsektorale (NJVV, DRSHSSH, Drejtoritë Rajonale të Punësimit, etj., sipas nevojave të identifikuar) të ngritura dhe funksionale nën koordinimin e NJVKSH-ve përkatëse (Tiranë dhe Kavajë)/ DROSHKSH, Tiranë për ofrimin e shërbimeve që mundësojnë jetesën e pavarur; Të paktën 6 seanca psikoedukimi për kujdestarët/asistentët personalë dhe familjarët e personave me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor, përfitues të shërbimit të apartamenteve të mbështetura, nëpërmjet informimit për identifikim e nevojave për shërbime socio-shëndetësore dhe fuqizimit të aftësive aadvokuese për këta persona.	2023-2024	3,840	507	2,803	7,150	3,840	507	-	4,347	2,803	-
----	---	----------------------------	---	-----------	-------	-----	-------	-------	-------	-----	---	-------	-------	---



13	Ofrimi i shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve, sipas nevojave;	MSHMS	Ofrimi i shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve psikiatër, i siguruar;	2023-2026	13,680	-	-	13,680	13,680	-	-	13,680	-	-
14	Sigurimi i diagnostikimit (ekzaminimeve kliniko-biokimike, imazherike, konsultave të specializuara, etj.) dhe trajtimit të specializuar (ndërhyrje kirurgjikale, etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e kujdesit shëndetësor Lezhë, nëpërmjet Spitalit Rajonal Lezhë dhe strukturave të tjera spitalore univeritare;	MSHMS	Ekzaminimet e ndryshme kliniko-biokimike, imazherike, konsulta të specializuara, etj. dhe trajtimi i specializuar (ndërhyrje kirurgjikale, etj.) për problematika të ndryshme shëndetësore të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë, të ofruara nga shërbimet shëndetësore;	2023-2026	2,073	4,800	-	6,873	2,073	4,800	-	6,873	-	-

15	Ofrimi i ekzaminimeve laboratorike, depistimeve epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e kujdesit shëndetësor Lezhë;	MSHMS	Shërbimet e shëndetit publik të ofruara sipas nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të akomoduar në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor Lezhë	2023-2026	1,036	-	-	1,036	1,036	-	-	1,036	-	-
----	---	-------	--	-----------	-------	---	---	-------	-------	---	---	-------	---	---

**Objektivi specifik 1.4: Zhvillim i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve socio-shëndetësore në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor**

1	Vazhdimi i politikës së hapjes së specializimeve dhe ruajtja e kuotave vjetore në specializimet për psikiatrinë për adultë dhe për fëmijët dhe adoleshentët si kuota të mbuluara nga MSHMS;	MSHMS, MAS, FM	Të paktën 8 mjekë ndjekin specializimin në psikiatrinë për adultë dhe 4 për psikiatrinë për fëmijë dhe adoleshentë, si kuota të mbuluara nga MSHMS;	2023-2026	34,560	-	-	34,560	34,560	-	-	34,560	-	-
2	Pasurimi i kurrikulave universitare të mjekësisë dhe infermierisë me module me fokus të veçantë në shëndetin mendor komunitar;	MSHMS, MAS, FM	Kurrikula universitare të mjekësisë dhe infermierisë të përditësuara për çështjet e shëndetit mendor;	2025-2026	2,045	2,400	-	4,445	2,045	-	-	2,045	-	2,400

3	Zgjerimi dhe pasurimi i shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor ku realizohet praktika universitare e mjekësisë dhe infermierisë së përgjithshme;	<b>MSHMS, FM</b>	Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë e Mbështetura me praktikën më të mirë, si dhe QSH-të me shërbimin më të mirë psikosocial ofrojnë praktika universitare;	<b>2025-2026</b>	<b>186</b>	-	-	<b>186</b>	<b>186</b>	-	-	<b>186</b>	-	-
4	Përmirësimi i qëndrimeve dhe praktikave në shëndetin mendor nëpërmjet zbatimit të një qasjeje të bazuar në të drejtat dhe të orientuar drejt rimëkëmbjes të shërbimeve të shëndetit mendor, sipas parimeve të OBSH-së "WHO QualityRights" ("Të drejtat e barazisë sipas OBSH-së");	<b>MSHMS, OBSH</b>	Të paktën 300 stafe multidisiplinare të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor të trajnuar sipas "WHO QualityRights" ("Të drejtat e barazisë sipas OBSH-së");	<b>2024-2025</b>	<b>224</b>	-	-	<b>224</b>	<b>224</b>	-	-	<b>224</b>	-	-
5	Përmirësimi i njohjes dhe adresimit, nga ana e ofruesve të shërbimeve të shëndetit mendor, të problematikave të shëndetit mendor të grupeve të cenueshme, si: viktimat e trafikimit, ekstremizmit të dhunshëm, viktimat e dhunës dhe abuzimit, flukset mikse migratore, etj.	<b>MSHMS, MB, CVE, KiE, DONATORËT</b>	duke u fokusuar veçanërisht te të burgosurit e liruar në rrezik radikalizimi, janë projektuar/ përmirësuar dhe pilotuar me sukses; Manual/ udhëzues për shëndetin mendor të viktimave të trafikimit dhe dhunës dhe abuzimit, i hartuar; Manual/ udhëzues për shëndetin mendor të migrantëve, i hartuar; 12 trajnime multisektoriale në 12 qarqet e vendit mbi shëndetin mendor të grupeve të cenueshme (viktimat e trafikimit, ekstremizmit të dhunshëm, viktimat e dhunës dhe abuzimit, flukset mikse migratore, etj.).	<b>2024-2026</b>	<b>1,559</b>	<b>8,500</b>	-	<b>10,059</b>	<b>309</b>	-	-	<b>309</b>	<b>1,250</b>	<b>8,500</b>

6	Ngritja dhe fuqizimi i shërbimit psikosocial në KSHP, në kuadër të integritimit socio-shëndetësor;	<b>MSHMS</b>	100% e QSH-ve me shërbim psikosocial të intergruar nëpërmjet atashimit të stafëve psikosociale në këtë nivel shërbimesh dhe kualifikimit të tyre për trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor;	<b>2023-2026</b>	<b>336,000</b>	-	-	<b>336,000</b>	<b>336,000</b>	-	-	<b>336,000</b>	-	-
7	Rritja e kapaciteteve të stafëve sociale të NJVV-ve për identifikimin e nevojave socio-ekonomike të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe referimin në shërbime, sipas kaudirt ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të parimeve të gjithpërfshirjes, mosdiskriminimit dhe respektit për të drejtat themelore të njeriut.	<b>MSHMS, OSHKSH/ NJVKSH, NJVV</b>	100% e stafëve të NJVV janë informuar mbi problematikat socio-ekonomike të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe shërbimet nëpërmjet të cilave këto problematika mund të trajtohen;	<b>2023-2026</b>	<b>3,091</b>	<b>800</b>	-	<b>3,891</b>	<b>3,091</b>	-	-	<b>3,091</b>	<b>800</b>	-
8	Klasifikimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore sipas nivelit të rrezikut nga stafe të kualifikuara mbi këto procedura;	<b>MSHMS, MD, DPB, KiE, HFIII</b>	Trajnime të grupeve të punës për përcaktimin e kriterëve për kryerjen e një vlerësimi të riskut dhe klasifikimi për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të realizuara;	<b>2024</b>	<b>1,091</b>	-	-	<b>1,091</b>	<b>1,091</b>	-	-	<b>1,091</b>	-	-

9	Zbatimi i ndërhyrjeve të strukturuar dhe në përgjigje të nevojave të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore nëpërmjet hartimit të planeve individuale të trajtimit;	<i>MSHMS, MD, DPB, KiE, HFIII</i>	Asistencë në hartimin e planeve individuale të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, e siguruar;	2024-2025	1,091	-	-	1,091	1,091	-	-	1,091	-	-
10	Përmirësimi i ndërhyrjeve rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore;	<i>MSHMS, MD, DPB, KiE, HFIII</i>	Programet rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të zhvilluara; 100% e ofruesve të programeve rehabilituese për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të trajnuar për zbatimin e tyre;	2024-2025	1,091	-	-	1,091	1,091	-	-	1,091	-	-
11	Mbështetja e stafeve klinike për ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.	<i>MSHMS, MD, DPB, KiE, HFIII</i>	Kurrikulat e trajnimit në vendin e punës për ofrimin e shërbimit psikiatrik për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të hartuara; 100% e stafeve klinike të trajnuar për ofrimin e shërbimeve multidisiplinare për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.	2024	1,364	2,400	-	3,764	1,364	1,200	-	2,564	-	1,200

**Objektivi specifik 1.5: Digjitalizim i shërbimeve të shëndetit mendor dhe përmirësimi i informacionit lidhur me shëndetin mendor si nevojë për vendimmarrje në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve**

1	Zhvillimi i digjitalizimit edhe në shërbimet e specializuara të shëndetit mendor, pjesë e projekteve të digjitalizimit të shërbimeve shëndetësore;	<i>MSHMS</i>	100% e shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor janë përfshirë në sistemet shëndetësore digjitale; 100% e stafeve përdoruese të sistemeve elektronike të trajnuara;	2024-2026	2,398	50	-	2,448	2,398	50	-	2,448	-	-
